



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËMPERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë
Bachelor në “Informatikë Ekonomike”,
me profile: "Menaxhim Biznesi", "Financë dhe Bankë"
“Universiteti European i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli

Prof. Asoc. Dr. Esmeralda Shehaj

Mars/ 2020



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelornë 'Informatikë Ekonomike' me profile "Financë dhe Bankë" dhe "Menaxhim Biznesi" është një program studimi me kohë të plotë, me 180 kredite, që ofrohet në 6 semestra apo 3 vite akademike, në përfundim të të cilave merret diploma me profilin përkatës. Programi është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 452, datë 14.09.2011, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit nr 152, datë 18.02.2011. Programi është akredituar për herë të parë me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 251, date 14.06.2013, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit, nr. 467, datë 03.05.2013, me afat 6 vjeçar, deri në 13 Qershor 2019.

Brezi i fundit i studentëve të regjistruar në këtë program ka qenë në vitin akademik 2017-2018, sepse ky program është mbyllur tashmë. Arsyeja e mbylljes është kërkesa e UET për riorganizimin e tij në një program studimi me 5 profile. Bazuar në Urdhërin e MASR, Nr. 551, datë 11.09.2018, programi u riorganizua në "Bsc në 'Teknologji Informacioni', me 5 profile: *Informatikë Ekonomike; Hartim Software; Inxhinieri Telekomunikacioni; Grafikë-Dizajn; dhe Multimedia*". Që nga viti akademik 2018-2019 në UET është aktiv vetëm program i riorganizuar (nuk është objekt i këtij Raporti).

Programi i studimit Bsc në "Informatikë Ekonomike, me 2 profile: "Financë dhe Bankë", "Menaxhim Biznesi", ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, njësi e strehuar në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, i licencuar me VKM Nr. 255, datë 27.02.2008 dhe i riorganizuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 527, datë 04.09.2018.

Në vitin akademik 2018 – 2019 programi i studimit Bsc në "Informatikë Ekonomike" me 2 profile është administruar nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, njësi bazë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës.

Që prej fillimit të vitit akademik 2019-2020, u vendos që programi të administrohet përsëri nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, tashmë pranë Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit dhe do të qëndrojë nën këtë administrim deri në diplomimin e studentit të fundit.

UET ka përcaktuar qartë drejtimit prioritar akademike në dokumentat e veta strategjike dhe synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave të tij në përputhje me kërkesat e "Kartës së Bolonjës" dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioritetëve synohet nëpërmjet përmbushjes së Objektivave Strategjike të përcaktuara në Statutin e UET, [ku cit], *UET synon profilizimin e universitetit si një "universiteti i biznesit", duke i dhënë përparësi ndërtimit të kurrikulumeve, strukturës së programeve e diversitetit të diplomave e profileve në funksion të kërkesave të tregut të punës në nivel kombëtar e rajonal.*

Përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete. Ofrimi i programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" me profile "Financë dhe Bankë" dhe "Menaxhim Biznesi", emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat e drejtimit akademike të UET. Ky program studimi ofron njohuri teorike dhe aftësi praktike në ekonomiks, financë, kontabilitet, programim, rrjeta kompjuterike, etj. Studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë mund të punësohet në institucione të ndryshme si specialist në sektorin e Teknologjisë së Informacionit si në sektorin publik edhe atë privat.

Ky raport i përgatitur nga ana e Grupi të Vlersimit të Jashtëm ka për qëllim vlerësimin në kuadër të ri-akreditimit për programin e studimit Bachelor në 'Informatikë Ekonomike' me profile "Financë dhe Bankë", "Menaxhim Biznesi", vetëm për studentët që diplomohen në vitin 2019-2020 dhe/ose

studentët e mbartur që akoma nuk kanë përfunduar studimet, në brezat e mëparshëm. (Në këtë program që ngaviti akademik 2018-2019 e në vazhdim nuk janë regjistruar studentë të rinj dhe ka pasur 38 studentë të regjistruar në vitin e dytë dhe 158 studentë të regjistruar në vitin e tretë).

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", me profile: a) Financë dhe Bankë; b) Menaxhim Biznesi, është akredituar për herë të parë në vitin 2013, bazuar në Urdhërin e MASH, Nr. 251, datë 14.06.2013, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 467, datë 03.05.2013. Në këtë Vendim KA ka dhënë disa rekomandime.

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

1. Realizimin e studimit të tregut bazuar në metoda dhe instrumenta të provuar për të identifikuar pritshmëritë e punëdhënësve për aftësitë që studentët duhet të zotërojnë në përfundim të studimeve në programin e studimit "Bsc Informatikë Ekonomike, me profile: Financë dhe Bankë; Menaxhim Biznesi".
2. Implementimin e një sistemi të qëndrueshëm për automatizimin e menaxhimit të studentëve dhe personelit.
3. Pasurimin e faqes së internetit me të dhëna mbi procesin dhe rezultatet e akreditimit të institucionit dhe programeve mësimore.
4. Pasurimin e faqes së internetit me rezultatet e vlerësimit të nxjerra nga KSBC si dhe rezultatet që universiteti synon të arrijë.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

Referuar dokumentacionit të ardhur nga institucioni si dhe vizitës në institucion në përputhje me axhendën, GVJ konfirmon se janë përbushur plotësisht 3 nga 4 rekomandimet e lëna nga akreditimi i vitit 2013 kurse 1 rekomandim konsiderohet i përbushur pjesërisht. Konkretisht:

1. **Realizimin e studimit të tregut bazuar në metoda dhe instrumenta të provuar për të identifikuar pritshmëritë e punëdhënësve për aftësitë që studentët duhet të zotërojnë në përfundim të studimeve në programin e studimit "Bsc Informatikë Ekonomike, me profile: Financë dhe Bankë; Menaxhim Biznesi".**

GVJ mendon se: Ky rekomandim është përbushur nga IAL sepse institucioni ka realizuar studimin e tregut, të mbështetur në metoda dhe instrumenta të provuara për të identifikuar pritshmëritë e punëdhënësve për aftësitë që studentët duhet të zotërojnë në përfundim të studimeve në programin e studimit në fjalë. Këtë studim institucioni e ka bazuar tek opinionet dhe sugjerimet e punëdhënësve, të anëtarëve të bordeve të tregut të punës, të përfaqësuesve të kompanive në vend dhe rajon, si dhe të studentëve të cilët kanë përfunduar studimet në programin Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Rezultatet e këtyre studimeve janë pasqyruar në dokumentat e vëna në dispozicion nga institucioni: Studim për tregun e punës përpara hapjes së programit të studimit; Studim periodik për tregun

e punës pas daljes së studentëve; Të dhëna tabelore për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve.

2. Implementimin e një sistemi të qëndëruar për automatizimin e menaxhimit të studentëve dhe personelit.

GVJ mendon se: Ky rekomandim është përmbushur nga IAL sepse institucioni ka investuar në implementimin e një sistemi të qëndëruar për automatizimin e menaxhimit të studentëve dhe personelit, duke ofruar dy sisteme të automatizuara LMS dhe UMS, të cilat u vijnë në ndihmë si pedagogëve ashtu edhe studentëve për të shkëmbyer informacione në mënyrë të vazhdueshme duke i menaxhuar nga zyra, shtëpia apo telefoni aplikacionet në fjalë nga të dyja palët e interesuara. Personeli akademik, sekretaria dhe studentët i përdorin gjerësisht këto sisteme duke realizuar një komunikim në koherencë dhe të suksesshëm mes palëve. GVJ u njoh konkretisht me sistemet LMS dhe UMS gjatë vizitës në institucion në takimin me drejtuesin e zyrës së TI, si dhe nga dokumentat e vëna në dispozicion: Manual i përdoruesit të sistemit UMIS; Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS; UET-LMS guidë për pedagogun; UET-LMS guidë për studentin.

3. Pasurimin e faqes së internetit me të dhëna mbi procesin dhe rezultatet e akreditimit të institucionit dhe programeve mësimore.

GVJ mendon se: Ky rekomandim është përmbushur nga IAL sepse institucioni ka përditësuar informacionet e paraqitura në faqen e internetit duke pasqyruar gjithashtu të dhëna mbi procesin dhe rezultatet e akreditimit të institucionit dhe programeve mësimore. Këto informacione gjenden në linkun në vijim: <http://uet.edu.al/new/raporte-vleresimi/>

4. Pasurimin e faqes së internetit me rezultatet e vlerësimit të nxjera nga KSBC si dhe rezultatet që universiteti synon të arrijë.

GVJ mendon se: Ky rekomandim është përmbushur pjesërisht nga IAL sepse rezultatet e vlerësimit të nxjera nga KSBC ai i vë në dispozicion të të interesuarve sipas kërkesës, si dhe rezultatet që universiteti synon të arrijë i ka pasqyruar në dokumentat e veta strategjike: Plan i strategjik 2015-2020.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të kontratuar nga ASCAL. Për hartimin e raportit, veç raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore që grupi kreu në institucion, si dhe mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Zyrës së Standardeve dhe Cilësisë, etj.

Në bazë të vlerësimit kanë qënë kriteret e vendosura në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave dhe rishikimi i kriterëve e kërkesave ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit “Bachelor” në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Vizitat në institucion u kryen në datat 12 dhe 13 Dhjetor 2019. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimit të cilësisë, etj.

Institucioni dorëzoi dokumentat dhe evidencat e nevojshme për akreditimin në format elektronik tek ASCAL; gjithashtu, gjatë vizitës së GVJ në institucion u paraqitën evidenca të ndryshme për të mbështetur aplikimin e tyre për akreditimin e programit të studimit të nivelit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” me dy profile. Programi i studimit është ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit por për shkak të historikut dhe përmbajtjes kurrikulare, ky program studimi vijon të ofrohet në bashkëpunim me Departamentin e Informatikës dhe Teknologjisë, pjesë e Fakultetit të Inxhinjerisë, Informatikës dhe Arkitekturës.

Koordinator teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është ME. Renata Qatipi.

Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm u bë për shkak të kushteve të jashtëzakonshme pas tërmetit të 26 Nëntorit (UET dhe ekspertët patën pengesa për tu angazhuar sipas parashikimit).

Më datë 03.02.2020, përmes sistemit AMS, Universiteti Europian i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

UET më datë 04.02.2020 përcjell nëpërmjet AMS, dhe me shkresë nr.06/19 Prot. datë 04.03.2020 komentin që “UET bie dakord me përmbajtjen e draft raportit dhe nuk e sheh të nevojshme të paraqesë ndonjë koment apo plotësim në lidhje me të”.

Në këtë rast Draft Raporti kthehet në Raport përfundimtar

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Informatikë Ekonomike” me profile “Menaxhim Biznesi” dhe “Financë dhe Bankë”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Institucioni i Arsimit të Lartë UET ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Kjo gjë është e shprehur qartësisht në Planin Strategjik 2015 – 2020 të UET sipas të cilit ky institucion synon të jetë <i>“një universitet lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, do të punojë në përputhje me modelin sipas së cilit arsimit i lartë ka një rol parësor e unik në përmirësimin e kohezionit social të një vendi, duke prodhuar produkte sa më cilësore në shërbim të shoqërisë, ekonomisë, politikës dhe zhvillimit të qëndrueshëm afat-gjatë”</i> .
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	UET i ka hartuar programet e studimit në përputhje me ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. GVJ e konstaton këtë në dokumentat strategjike të institucionit sipas të cilave <i>“UET do të punojë vazhdimisht për thellimin e traditave më të mira universitare shqiptare, si dhe do të kontribuojë në thellimin e lirisë akademike, dëshirës për ndjekjen e studimeve universitare, krijimin e disiplinës akademike e intelektuale në emër të karrierave sa më të qëndrueshme e cilësore”</i> (Plani Strategjik 2015 – 2020, Vizioni).
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Sipas Statutit të UET, Kreu 1 Neni 6 qëllimi dhe misioni i UET është <i>“t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke përthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm, t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe partneriteteve në tregun e punës e atyre ndërkombëtare”</i> . Mbështetur tek Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” me profile është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit duke ofruar kurrikula dhe mësimdhënie cilësore.
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Sipas Planit Strategjik për Zhvillimin e Programit dhe dokumentave të tjera të vëna në dispozicion GVJ konstaton se nëpërmjet këtij programi UET ka synuar të ofrojë studime në përputhje me nevojat aktuale të tregut lokal dhe kombëtar. Mbledhjet që zhvillohen me Bordin e Tregut të Punës si dhe studimet që ka bërë UET mbi kërkesat e tregut në këtë drejtim, kanë ndihmuar në përputhshmërinë e këtij programi me nevojat e tregut të punës. Të diplomuarit në këtë program studimi fitojnë njohuri teorike dhe aftësi praktike në ekonomiks, financë, kontabilitet, programim, rrjeta kompjuterike, etj. Studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë mund të punësohet në institucione të ndryshme si specialist në sektorin e

	Teknologjisë së Informacionit si në sektorin publik edhe atë privat.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” me profile Financë dhe Bankë dhe Menaxhim Biznesi është hartuar në përshtatje me strategjinë e zhvillimit të vetë institucionit e mbështetetur kjo tek dokumentat strategjike të tij. Sipas Planit Strategjik 2015–2020 dhe Planit Strategjik për Zhvillimin e Programit institucioni synon të jetë një qendër ekspertize e specializuar në fushën e studimeve shoqërore – politike, ekonomike, juridike dhe në fushën e teknologjisë, në vend dhe me ndikim në rajon e më gjerë. Sistemi i njohurive që ofrohet nga programi i studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” me dyprofile dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre edhe ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhimit të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale.			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	GVJ konstatoi se UET ka përcaktuar qartë drejtimit prioritar akademike në dokumentat e veta strategjike të tilla si Plani Strategjik 2015–2020 Prioritetet , sipas të cilave institucioni synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave të tij në përputhje me kërkesat e “Kartës së Bolonjës”, dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioritetëve synohet nëpërmjet përmbushjes së Objektivave Strategjike të përcaktuara në Statutin e UET Neni 6. Gjatë vizitës në institucion dhe në bazë të dokumentave të tjera të programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” me dyprofile, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete.			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Sipas Planit Strategjik 2015 – 2020 Objektivat Strategjike, UET synon profilizimin e universitetit si një “universiteti i biznesit”, duke i dhënë përparësi ndërtimit të kurrikulumeve, strukturës së programeve e diversitetit të diplomave e profileve në funksion të kërkesave të tregut të punës në nivel kombëtar e rajonal. Këtë gjë UET e ka bërë edhe nëpërmjet ofrimit të programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” me 2 profile Financë dhe Bankë dhe Menaxhim Biznesi, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e të cilit është në përputhje me fushat e drejtimit akademike të UET.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Mbështetur tek dokumentat strategjike të UET, Plani Strategjik 2015 – 2020, GVJ konstaton se UET ka si Objektiv Strategjik profilizimin e UET si një “universitet të biznesit”, duke i dhënë përparësi ndërtimit të kurrikulumeve, strukturës së programeve e diversitetit të diplomave e profileve në funksion të kërkesave të tregut të punës në nivel kombëtar e rajonal.</p> <p>Sipas Planit Strategjik për Zhvillimin e Programit, objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike me 2 profile është t’u japë studentëve njohuritë bazë formuese në fushën e bazave të të dhënave, programimit, multimedias, etj, me objektiv kryesor formimin e specialistëve të informatikës së aplikuar në biznes dhe për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë. GVJ konstaton se dijet që marrin studentët në përfundim të këtij programi studimi në fusha të tilla si gjuhët e programimit, arkitektura e kompjuterave, sistemet e operimit, algoritmike, strukturë të dhënash të kombinuara me njohuritë në fusha të tjera si statistikë, ekonometri, matematikë e zbatuar në ekonomi, mikroekonomi, makroekonomi e karakterizojnë profilin e tij.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimit real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në bazë të dokumentit “Studim për tregun e punës përpara hapjes së programit” si dhe nga bisedat e zhvilluara me drejtuesit e institucionit, GVJ konstatoi se UET ka zhvilluar një studim të tregut të punës përpara hapjes së këtij programi studimi, i bazuar tek të dhëna të marra nga fokus grupet, intervistat dhe anketimet, mbi bazë të të cilave ka qartësuar elementët bazikë të programit të studimit, emërtimin e programit, profilet, si dhe mundësitë për punësimin e të diplomuarve. Në dokumentin “Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve” gjenden të dhënat statistikore të numrit të të diplomuarve dhe të punësuarve për këtë program studimi nga viti 2013-2018.</p> <p>Për plotësimin e rekomandimit të KA institucioni ka realizuar një studim të tregut të mbështetur në metoda dhe instrumenta të provuara për të identifikuar pritshmëritë e punëdhënësve për aftësitë që studentët duhet të zotërojnë në përfundim të studimeve. Gjithashtu një rëndësi të madhe i është dhënë për këtë qëllim takimeve me anëtarët e bordeve të tregut të punës, takimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga përfaqësues të kompanive të ndryshme që operojnë në tregun vendas dhe rajonal, sikurse dhe eksperiencave të studentëve të cilët kanë përfunduar studimet në programin Bachelor “Informatikë Ekonomike”.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e</p>	<p>Sipas “Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike”, me profile Financë dhe Bankë dhe Menaxhim Biznesi struktura e këtij programi studimi është e organizuar në 5 kategori të lëndëve formuese dhe ofron mundësinë e profilizimit në 2 profile. Ky program studimi përgatit studentë me njohuri bazë në drejtimin ekonomik dhe informatikë, duke ju siguruar atyre mundësi punësimi si specialistë ekonomie me njohuri në fushën e</p>

studentëve.	<p>informatikës apo informaticien me njohuri në fushën e ekonomisë.</p> <p>Objektiv i këtij programi është përgatitja e specialistëve të informatikës të aftë në implementimin e sistemeve teknologjike për zgjidhjen e problemeve ekonomike. Për realizimin e këtij objekti në program janë përfshirë lëndë të tilla si: Arkitektura e Kompjuterit, Algoritmikë dhe Hyrje në Programim, Strukturë të Dhënash, Programim 1, Programim 2 të kombinuara me lëndët nga fusha e ekonomisë si Hyrja në Ekonomi, Hyrje në Menaxhim Risku, Hyrje në Menaxhim sidhe lëndë të tjera si Statistikë, Matematikë 1, Matematikë 2, etj.</p> <p>Nga ana tjetër për të garantuar që dijet e përfituara i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve, institucioni ka kryer takime frekvente ku ka ndarë me ish studentët mendimet mbi përvojat e tyre personale në tregun e punës dhe ka kërkuar sugjerime e përshtypje për ndryshime, reformime e përmirësime të mundshme. Në diskutimet që u zhvilluan gjatë vizitës në institucion me drejtuesit e fakultetit dhe departamentit përgjegjës GVJ u informua që programi është konceptuar të riorganizohet si efekt i studimit të tregut të punës dhe duke marrë në konsideratë sugjerimet dhe kërkesat e punëdhënësve dhe të studentëve alumni.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” me dy profile është ofruar fillimisht nga viti 2011 deri në vitin 2018 nga Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit. Në vitin 2018 me Urdhër Nr. 527 dhe Urdhër 551 të Ministrit të MASR, Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit u riorganizua në Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, dhe ky program studimi u riorganizua në Bachelor “Teknologji Informacioni” me pesë profile dhe u ofrua për vitin akademik 2018-2019 nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, Fakulteti i Inxhinjerisë, Informatikës dhe Arkitekturës.</p> <p>GVJ u informua gjatë bisedave me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi se duke qenë se pas riorganizimit programi u profilizua më shumë në Teknologjinë e Informacionit, u vendos që nga viti akademik 2019-2020 e deri në shuarjen e tij, programi Bachelor “Informatikë Ekonomike” me dy profilet Financë dhe Bankë dhe Menaxhim Biznesi, të ofrohet përsëri nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësi bazë përgjegjëse, nën drejtimin e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, por duke vijuar bashkëpunimin me Departamentin e</p>

	<p>Informatikës dhe Teknologjisë.</p> <p>GVJ është i mendimit se institucioni ofron kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij programi studimi duke marrë në konsideratë bashkëpunimin e dy departamenteve të dy fakulteteve të sipërpërmendura dhe duke angazhuar përkatësisht në Fakultetin e Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës 24 pedagogë si personel akademik efektiv, prej të cilëve 6 të kategorisë Profesor, 5 të kategorisë Lektor dhe 13 të kategorisë Asistent Lektor, ndërsa në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit 35 pedagogë si personel akademik efektiv, nga të cilët 12 të kategorisë Profesor, 11 të kategorisë Lektor dhe 12 të kategorisë Asistent Lektor (Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit).</p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” me dy profile Financë dhe Bankë dhe Menaxhim Biznesi që nga viti akademik 2019 - 2020 e deri në shuarjen e tij ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësi bazë përgjegjëse nën drejtimin e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit si njësi kryesore, por duke vijuar bashkëpunimin me Departamentin e Informatikës dhe Teknologjisë, pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës.</p> <p>Sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane, në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet të sigurojë përputhjen e fushës akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë që kontribuojnë në realizimin e programit me fushën e përgjithshme dhe specifike të programit të studimit. Duke u mbështetur tek dokumentat e vënë në dispozicion nga institucioni për strategjinë e kërkimit shkencor për vitet 2017 – 2020 GVJ konstatoi se direktivat dhe udhëzimet kombëtare evropiane plotësohen.</p> <p>Raporti Vjetor, Viti akademik 2017 – 2018;</p> <p>Të dhëna për lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda</p>	<p>Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” me dy profile, Financë dhe Bankë dhe Menaxhim Biznesi, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut,</p>

<p>institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit përgjegjës për këtë program studimi, bashkëpunon me Departamentin e Informatikës dhe Teknologjisë, pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Bazuar tek ky bashkëpunim por edhe tek dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni (Rregullore e UET; Dokument Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Departamentit; Analizë Vjetore e Departamentit Informatikë dhe Teknologji mbi Arritjen e Objektivave Formuese të Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”, etj.)GVJ është i mendimit se UET ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>GVJ ka konstatuar se institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe aktorët e biznesit vendës (p.sh. Ludwigshafen Hochschule, University Nova de Lisboa, Portugal, Infosoft Group, Mikrotik, etj) bazuar kjo tek dokumentat e vëna në dispozicion të tilla si: Raporti vjetor, Viti Akademik 2017 – 2018; Projekti 250+, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion (Raporti vjetor, Viti Akademik 2017–2018; DSSH 2019; Projekti 250+; Ndërkombëtarizimi; Raporti i Përfitimeve nga Marrëveshjet e Bashkëpunimit) GVJ mendon se njësia përgjegjëse për këtë program ka hartuar në mënyrë periodike raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të këtij programi studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Në bazë të Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike” praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Përgjegjësi i Departamentit përkatës, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës. Zhvillimi i praktikës profesionale rregullohet me rregullore të veçantë. Lidhur me aftësimin profesional, programi i studimit përfshin lëndën Praktikë Profesionale, e cila është bërë në bashkëpunim me kompaninë letoneze Mikrotik. Nëpërmjet praktikës profesionale, studentët fitojnë eksperiencë praktike në fushën e rjetave kompjuterike. Në mbështetje të dy profileve të këtij programi studimi Praktika Profesionale është bërë edhe për aftësimin e studentëve në përdorimin e dy programave Alpha dhe Financa 5. Gjithashtu, në lëndë të veçanta, organizohen orë të hapura me specialistë të fushës përkatëse, në të cilat studentët marrin informacion të thelluar mbi një temë të caktuar.</p> <p>Në bazë të dokumentave “Marrëveshjebashkëpunimi” si dhe mbështetur tek RVB, GVJ evidentoi se institucioni ka nënshkruar marrëveshje me kompani të njohura në fushën e TI por jo vetëm, të tilla si Infosoft; Balfin shpk; AMF; INSTAT; Dhoma e tregtise dhe Industrise; AWARD Group Consultants; E.H.W shpk; QWWEB shpk.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjeshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjeshme për studentët, si p.sh. Shkolla Dimërore 2019. Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, Projekti 250+ dhe një sërë</p>

punëdhënësit.	Memorandumesh dhe Marëveshjes Bashkëpunimi, evidentojmë që janë organizuar takime me përfaqësues të bankave që operojnë në Shqipëri si dhe takime e leksione të hapura me ekspertë dhe profesionistë të fushës së Teknologjisë së Informacionit. Qëllimi dhe objektivat e këtyre marrëveshjeve apo takimeve kishin në fokus kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave mësimore apo organizimin e trajnimeve profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga institucioni (RVB; Rregullore e UET, Neni 1 Baza Ligjore, Neni 13 Forma e studimit; Kurrikula e Programit; Planit Mësimor, etj) se studimet në programin e studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” dy profile “Financë dhe Bankë” dhe “Menaxhim Biznesi”, janë si rregull me kohë të plotë, të organizuara në module ose lëndë dhe të shprehura në kredite përkatësisht 60 kredite në vit (në total 181 kredite), sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS), në frymën e Kartës së Bolonjës.
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Sipas Planit Strategjik për Zhvillimin e Programit, Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë Ekonomike” me dy profile i ofron studentëve mundësinë e përfitimit të njohurive teorike dhe aftësi praktike në ekonomiks, financë, kontabilitet, programim, rrjeta kompjuterike dhe në modelimin e proceseve të biznesit dhe të të dhënave të ndryshme. Me anë të këtij formimi ata do të kenë mundësi të punojnë si programues, specialistë të aplikimeve të web, dhe mund të implementojnë edhe rrjetat kompjuterike. GVJ konstatoi se kjo gjë mbështetet tek kurrikula e programit nëpërmjet lëndëve Arkitekturë Kompjuteri & Rrjeta Kompjuterike, Programim 1 & Programim 2, Teori e bazave të dhënave & Strukturë të Dhënash, Web design, etj.
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	GVJ evidentoi se ky program studimi jep kryesisht njohuri të nivelit bazë. Në bazë të dokumentit “Mbi parimet e ndërtimit të programit

	të lëndës dhe të përdorimit të literaturës” parimi themelor i ndërtimit të programit të lëndës për këtë program studimi është: 70% të programit e zënë njohuritë bazë dhe konceptet e lëndës; 15% të programit e zënë njohuritë e thelluara, të aplikuara dhe krahasuese në lëndë; 15% e zënë analiza dhe kritika e teorisë dhe aplikimeve të fushës. Literatura e lëndëve ka kryesisht karakter gjithëpërfshirës.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	GVJ duke u bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit; Mbi Parimet e ndërtimit të Programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës) konstaton se objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” është t’u japë studentëve njohuritë bazë formuese në fushën e bazave të të dhënave, programimit, multimedias, etj me objektivi kryesor formimin e specialistëve të informatikës së aplikuar në biznes. Për realizimin e këtij objektivi programi parashikon studime në fusha të tilla bazë si gjuhët e programimit, arkitektura e kompjuterave, sistemet e operimit, algoritmikë, strukturë të dhënash, etj, të kombinuara me njohuritë në fusha të tjera si statistikë, ekonometri, matematikë e zbatuar në ekonomi, mikroekonomi, makroekonomi, etj. Gjithashu parimi themelor i ndërtimit të programeve të lëndëve është që 70% ta zënë njohuritë bazë. Në këtë aspekt GVJ është i mendimit se kryesisht ky program studimi zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca bazë në fushën e tij të studimit.
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Duke u mbështetur tek dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstatoi se në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në përputhje me to UET ka hartuar dokumentat e tij, të tillë si “Rregullore e UET” dhe “Rregullore e Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”, të cilat përcaktojnë strukturën e programit të studimit me të gjithë elementët e tij (Struktura e Programit, Pika 3.1 e Rregullores së Programit).
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Duke u mbështetur tek dokumentat e vëna në dispozicion (Rregullore e Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”, 3.1. Struktura e Programit të Studimit; dhe Kurrikula e Programit) GVJ konstatoi se ky program studimi i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese të grupuara sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite përkatësisht: Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori: <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme, 5 lëndë (37 ECTS). • Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore, 11 lëndë (90 ECTS). • Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, 5 lëndë (28 ECTS). • Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri

	informatike, praktika profesionale, 5 lëndë (25 ECTS).			
	<ul style="list-style-type: none"> Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues, (7 ECTS). 			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyllet kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbyllet detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i Studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” me profile “Financë dhe Bankë” dhe “Menaxhim Biznesi” gjatë vitin akademik 2019 – 2020 e në vazhdim ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësi bazë, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit si njësi kryesore, në UET. Duke u mbështetur tek dokumentat: Rregullore e UET; Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike”, GVJ është i mendimit se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyllet detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatorin e programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Për këtë program studimi koordinatori është caktuar me anë të Vendim Nr. 96, datë 03.12.2018, të Dekanatit të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës (si njësia kryesore bashkëpunuese me Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit për realizimin e programit). Koordinatorin është pedagog që mban titullin Prof. Dr. Ai është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale. Detyrat kryesore të koordinorit përcaktohen në Aneksin bashkëlidhur vendimit të emërimit, si edhe në aktet rregullatore të UET. Në bazë të dokumentacionit të paraqitur GVJ konstatoi se detyrat e koordinorit të programit janë të përcaktuara qartë në dokumentin “Aneks-Detyrat e koordinorit të programit të studimit” ku evidentohet që ai raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyllet detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbyllet detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	GVJ konstaton se Rregullorja e Universitetit Europian të Tiranës dhe Statuti i Universitetit Europian të Tiranës janë hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Përrarsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në përputhje me të gjitha vendimet, aktet ligjore e nënligjore në fuqi. GVJ është i mendimit se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyllet detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike bazuar kjo tek dokumentat e shqyrtuara të vëna në dispozicion (Rregullore e UET, Kreu II; Statuti i UET, Kreu II, Kreu III).
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë	Në bazë të Urdhërit nr. 527 datë 04.09.2018, Fakulteti i Ekonomisë,

<p>përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Biznesit dhe Zhvillimit, përgjegjës për këtë program studimi nga viti akademik 2019-2020 e në vazhdim, përbëhet nga 3 njësi bazë, në përputhje me kërkesat ligjore. Këto njësi bazë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës • Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut • Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm <p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësi përgjegjëse për këtë program studimi përmbush kërkesën e ligjit për numrin e PAE (të paktën shtatë anëtarë) dhe raportin me PAK, por që pjesa më e madhe e tyre nuk janë personel akademik që japin mësim në këtë program studimi, bazuar tek dokumenti “23.1.Të dhëna tabelare për personelin akademik, 2018 – 2019”. Përkatësisht numri i PAE është 9 pedagogë nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof. Dr., - 2 Prof. Asoc. Dr., - 4 Dr. - 1 Msc. <p>Numri i PAK është 7 pedagogë nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof. Asoc. Dr., - 2 Dr. - 3 Msc <p>Për vitin 2019-2020 kemi vetëm vitin e tretë që vijon mësimin në këtë program studimi, meqënëse nuk ka të regjistruar në vitin e parë dhe të dytë. Në bazë të dokumentit “Të dhëna tabelare për personelin akademik, 2019 – 2020” numri i pedagogëve është 14, të gjithë PAE nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof. Dr., - 1 Prof. Asoc. Dr., - 4 Dr. - 7 Msc. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi II.3 Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1.Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>GVJ evidentoi se njësi kryesore dhe njësi bazë që janë përgjegjëse për këtë program studimi disponojnë të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Këto informacione</p>

<p>organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>gjenden në dokumentat e mëposhtëme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regullore e UET; • Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike”; • Kurrikula e Programit Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike”; • Plani Mësimor i Programit Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike”. <p>Gjatë vizitës në institucion studentët na informuan që të gjithë informacionin e nevojshme në lidhje me programin e studimit dhe lëndët i marrin nëpërmjet syllabuseve të lëndëve dhe materialeve që hidhen në sistemin LMS.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar në dokumentin “Regullore e UET, Neni 16” në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi rregullat e organizimit të të gjitha programeve të studimit.</p> <p>Në përputhje me këtë rregullore, dokumenti “Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike””: Pika 3.1. Struktura e Programit të studimit” përcakton qartë lëndët, modulet, praktika dhe aktivitetet formuese të këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Ndarja specifike është e pasqyruar tek Kurrikula e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike” nga të cilat kemi:</p> <p>Veprimtaritë formuese në këtë program studimi grupohen në 5 kategori:</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme, 5 lëndë (37 ECTS). • Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore, 11 lëndë (90 ECTS). • Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, 5 lëndë (28 ECTS). • Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 5 lëndë (25 ECTS). • Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues, (7 ECTS). <p>GVJ konstatoi se Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. Kreditet e një discipline fitohen vetëm pas vlerësimit të studentit me notë kaluese, kjo e përcaktuar në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike”: Pika 4.</p> <p>Në bazë të dokumentit Plani Mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike”GVJ konstatoi se në të gjenden të gjitha informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Informacione të tjera të nevojshme në lidhje me këtë</p>

	program studimi, të tilla si, frekuentimi/ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve, etj., janë të paraqitura në “Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike” pika 5 dhe 6, si dhe në Rregulloren e UET, Kreu 5.			
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ bazuar tek shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion evidentoi se nëpërmjet Rregullores së UET Neni 11 dhe 35 dhe Statutit të UET Neni 37 përcaktohen kriteret e pranimit dhe transferimit të studentëve sipas legjislacionit në fuqi duke i orjentuar studentët specifikisht sipas rregullores së programit të studimit përkatës. Kriteret e pranimit dhe transferimit dhe ekuivalentimit të studentëve për këtë program studimi përcaktohen në dokumentin Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike” Pika 2 dhe Pika 9; Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve.			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	GVJ evidentoi që të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara gjenden qartësisht të shprehura në dokumentin “Plani Mësimor i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Informatikë Ekonomike”. Gjithashtu ky program studimi përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë ku gjenden informacionet e nevojshme për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, etj, në përputhje me formatet e miratuara.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Rregullorja Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike” Pika 10 përcakton që lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Sipas kësaj rregulloreje ndryshimet propozohen nga Departamenti, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. Propozimi për ndryshime në çdo rast vjen i argumentuar nga pala e interesuar. Ai shqyrtohet në Departament dhe nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe pastaj dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit. Meqë ky program studimi është i licensuar në gjuhën shqipe ndryshimet ruhen në gjuhën shqipe.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të	GVJ evidentoi se ngarkesa dhe struktura e programit të studimit Bachelor

<p>studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>“Informatikë Ekonomike” me dy profile është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike”, pika 3 dhe 4.</p> <p>Përcaktimet specifike për strukturën dhe kreditet e këtij programi studimi jepen në Planin Mësimor të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike”, përkatësisht ngarkesa në orë mësimore në auditor, si dhe puna individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të marrë së paku 181 ECTS.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ është i mendimit që kurrikula e programit të studimit në përgjithësi është një kurrikul që i përgjigjet qëllimit dhe objektivave të programit të studimit. Shpërndarja e lëndëve dhe praktikave i mundësojnë studentëve të këtij programi studimi rritjen e aftësive profesionale dhe punësimin e tyre. Objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor Informatikë Ekonomike është t’u japë studentëve njohuritë bazë formuese. Kjo gjë mbështetet edhe në dokumentat: Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës; Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike”.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>GVJ konstatoi se ky program studimi ofrohet në 3 vite mësimore, gjithsej 6 semestra me kohëzgjatje normale 15 javë/në një semestër, dhe në përfundim të tij studentët marrin 181 kredite (ECTS). Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe shpërndarja e krediteve sipas lëndëve bën të mundur arritjen e objektivave formues të këtij programi studim dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe arsimit profesional (Rregullore Mësimore e Programit të studimit, Pika 3.2 dhe 3.3; Planin mësimor i programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”; Kurrikula e programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”).</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ konstatoi në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion por edhe gjatë bisedave me drejtuesit, pedagogët dhe studentët që struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit. Në këtë program studimi parimi themelor i ndërtimit të programit të lëndës është parimi i rrahëve ku 70% të programit e zënë njohuritë bazë dhe konceptet e lëndës 15% të programit e zënë njohuritë e thelluara, të aplikuara dhe krahasuese në lëndë dhe 15% e zënë analiza dhe kritika e teorisë dhe aplikimeve të fushës. Bazuar të gjitha sa u thanë më sipër tek Planin mësimor i programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”; Kurrikula e programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”; Rregullore Mësimore e Programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”; “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës”.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të</p>	<p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, në përputhje me përcaktimet ligjore. Institucioni synon që zhvillimi i kurrikulave të programit ti referohet praktikave më të suksesshme ndërkombëtare, me qëllim rritjen e përputhshmërisë së tyre me</p>

studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	kurrikulat në universitetet perëndimore, për të lehtësuar transferimin e studimeve dhe njohjen e krediteve, dhe për të rritur mundësitë e bashkëpunimit me universitetet partnere për programe të përbashkëta studimi, ose dhënien e diplomave të dyfishta. Sipas Planit strategjik për zhvillimin e programit, sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre edhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale.			
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Rregullorja Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike” Pika 10 përcakton që syllabuset e lëndëve përditësohen çdo vit akademik. Propozimi për ndryshime bëhet nga pedagogët e lëndës, njësia përgjegjëse për zhvillimin e programit, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, sugjerimet që mund të vijnë nga konsultimet me Bordet e Tregut të Punës, etj. Gjithashtu sipas Rregullores së UET dhe bisedave me NJBSC, GVJ konstatoi se literatura e detyruar dhe ndihmëse i përket viteve të fundit. Kjo u vërtetua edhe në vizitën në Bibliotekë.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	GVJ kostaton në bazë të dokumentave (Plani mësimor i programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”; Kurrikula e programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”; Syllabuset e lëndëve; “Planit strategjik për zhvillimin e programit”) sesistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyrevazhdimin e studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale, por edhe punësimin e tyre direkt në përputhje me kërkesat e tregut.			
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ konstatoi në bazë të vizitës së bërë në institucion dhe Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike” Pika 10 se programi i studimit, plani mësimor, lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Ndryshimet propozohen nga Departamenti, Zyra e Kurrikulave, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme.			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	GVJ konstatoi në bazë të vizitës së bërë në institucion dhe Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike” Pika 10 se programi i studimit, plani mësimor, lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Ndryshimet propozohen nga Departamenti, Zyra e Kurrikulave, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Personeli akademik me

Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme i angazhuar në këtë

<p>kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>program studimi i përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përcaktuara në Rregulloren e institucionit Pika G.I. dhe janë në përputhje me Ligjin Nr. 8015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe Kodin e Punës, të ndryshuar.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Për realizimin e programit mësimor, specifikisht për vitin akademik 2018 – 2019, departamenti përgjegjës angazhoi personel akademik jo vetëm të vetë departamentit por bashkëpunoi edhe me departamente të tjera, si Informatikë dhe Teknologji, Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm, Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionit, Ekonomiks dhe Financë.</p>
	<p>Numri total i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi është 29, nga të cilët 23 janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 6 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 pedagogë me titullin Prof. Dr. - 9 me titullin Dr. - 17 pedagogë me Master Shkencor <p>Rezulton stafi PAE është mbi 79 % ndaj atij PAK. Të gjithë kanë kualifikimin e nevojshëm dhe gradat shkencore sipas kërkesave të ligjit. “23.1.Të dhëna tabelare për personelin akademik në programin e studimit, 2018 – 2019”</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me disa kontrata pune të pedagogëve efektivë dhe me kontratë.</p> <p>Në pjesën më të madhë të tij personeli akademik efektiv dhe me kontratë ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik që kërkon ligji si në drejtimin e programit të studimit edhe në zhvillimin e lëndëve përkatëse.</p> <p>Për vitin 2019-2020 kemi vetëm vitin e tretë që vijon mësimin në këtë program studimi, meqënëse nuk ka të regjistruar në vitin e parë dhe të dytë. Në bazë të dokumentit “Të dhëna tabelare për personelin akademik, 2019 – 2020” numri i pedagogëve është 14, të gjithë PAE nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof. Dr., - 1 Prof. Asoc. Dr., - 4 Dr. - 7 Msc.
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. GVJ konstatoi se pas ristrukturimit të njësisë kryesore në vitin 2019, kemi një përputhje të pjesëshme të fushës akademike e kërkimore të njësisë kryesore me këtë program studimi duke u fokusuar më shumë tek pjesa ekonomike, që përputhet me natyrën e kombinuar, informatike dhe ekonomike, të profileve të këtij programi studimi (Të dhëna për lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien). Megjithatë pjesa më e madhe e</p>

	pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi i përkasin departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë dhe fusha e tyre akademike-kërkimore është në përputhje me natyrën e këtij programi studimi.			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Nëpërmjet nënshkrimit të një sërë “marrëveshjesh bashkëpunimi” me kompani të njohura në vend, si Infosoft Systems Shpk, Mikrotik, të fushës së TI por jo vetëm, institucioni ka vënë në dispozicion personelin e mjaftueshëm dhe të kualifikuar për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Përsa i përket udhëheqjes së punimit të diplomës kjo bëhet kryesisht nga pedagogët efektivë, të cilët gjithashtu kanë kualifikimin e duhur në përshtatje me programin e studimit.			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në bisedat me drejtuesit dhe pedagogët e këtij programi studimi GVJ u informua që në ndihmë të këtij programi studimi është zyra e TI e cila ka katër punonjës, dy prej të cilëve janë në mbështetje të procesit mësimor dhe dy merren me çështjet teknike që lidhen me laboratorët dhe mjediset e tjera mësimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Gjatë vizitës në institucion, në takimet me pedagogët dhe studentët, si dhe pas shqyrtimit të dokumentave, GVJ konstatoi se UET ka përcaktuar në Rregulloren e Institucionit mënyrën e planifikimit të procesit mësimor dhe metodave të mësimdhënies sipas të cilit procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, punë laboratorike, detyra praktike, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, praktika profesionale, punim diplome, Provim të Përgjithshëm Përfundimtar, projekte etj. Në këtë aspekt mund të themi që institucioni përdor metoda të ndryshme dhe

	inovative në procesin e mësimdhënies.			
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimet me drejtuesit, pedagogët, studentët dhe anëtarët e KSBC-së, si dhe pas shqyrtimit të dokumentave (Rregullore e UET Neni 22), GVJ konstatoi se vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik kryhet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi të Dekanit, Përgjegjësit të Departamentit dhe/ose përgjegjësit të grup-lëndës përkatëse; • Vlerësimi të studentëve që kryhet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatit e tyre, si dhe fokus grupeve me studentët dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit; • Vetëvlerësimi; • Rezultateve të raporteve të KSBC-së; • Vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimi të Performancës që ngrihet nga Rektori (folloë-up). • Leksioneve të hapura, për një nga temate planifikuara. <p>Rezultatet e përpunuara u bëhen me dije personelit akademik të interesuar dhe autoriteteve drejtuese.</p>			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimi të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Në bazë të Rregullores së UET Neni 22 institucioni ka garantuar përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies. Gjithashtu institucioni ju ka dhënë mundësinë studentëve që nëpërmjet pjesmarrjes së tyre në mbledhjet e departamentit të mund të diskutojnë dhe zgjidhin ankesat që kanë në lidhje me procesin mësimor.			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimi.	GVJ konstaton që Rregullorja e UET e përcakton në Nenin 22 bërjen publike të rezultateve të vlerësimi. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me disa nga dokumentat që përfshin ky proces të cilat ndodheshin në dosjet personale të pedagogëve.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimi dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	<p>Në takimin me përfaqësuesit e KSBC-së GVJ u informua që një nga objektivat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është monitorimi i vazhdueshëm i nivelit të cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik dhe ndihmës, përmes vlerësimi nga studentët (pyetësorë, focus grupe, etj.), si edhe kualifikimit të tij, përmes të dhënave nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Gjithashtu bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion mund të themi që UET kryen në vazhdimësi trajnimin e personelit akademik dhe promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1.Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Sipas Rregulloresë UET Neni 17; dokumentit “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës Pika A.III.3” dhe në takimet me studentët dhe pedagogët në institucion GVJ konstatoi se format e mësimdhënies për këtë program studimi janë ato të miratuara nga institucioni, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksionet: 60 kredite/672 orë mësimore në auditor - Seminarët: 69 kredite/504 orë mësimore në auditor - Projekte/detyra kursi/Laboratore:40 kredite/510 orë mësimore në auditor - Praktikë, Internship: 5 kredite/100 orë mësimore në auditor - Diplomë/provim përfundimtar: 7 kredite/ 20 orë mësimore në auditor <p>Gjithsej: 181 kredite/1806 orë mësimore në auditor</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>GVJ u informua në takimet me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi se personeli akademik është i gatshëm ti përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve duke ofruar forma e metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Një shembull i mirë është përshtatja e metodave të mësimdhënies dhe testimit të njohurive për persona me aftësi ndryshe.</p> <p>Gjithashtu në bazë të Rregullores së UET Neni 18për programet e studimit të ciklit Bachelor, mësimi për lëndët e Tipologjisë I, organizohet në grupe ku përfshihen jo më shumë se 2 grupe seminari. Mësimizhillohet në formë interaktive, duke integruar shpjegimin e pedagogut me diskutimet e studentëve. Ndërsa për lëndët e TipologjisëII mësimiorganizohet nëgrupe leksioni dhe seminari. Në grupet e leksionitpërfshihen jo më shumë se 6 grupe seminari.</p>
<p>Kriteri 3.Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni ka një politikë të qartë për mbështetjen e personelit të tij akademik në përmirësimin e vazhdueshëm në procesin e mësimdhënies. Për të përmbushur këtë objektiv institucioni zhvillon trajnime për përmirësimin e kompetencave didaktike të pedagogëve. Në bazë të dokumentit “Burimet Njerëzore Pika G.I.12. Certifikimi i Personelit” UET kryen në vazhdimësi trajnimin e personelit akademik. Në bazë të rolit që anëtari i personelit do të kryejë në institucion, atij do i duhet të marrë një ose disa prej certifikimeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Certifikatën e mësimdhënies dhe e këshillimit akademik; • Certifikatën e kërkimit shkencor; • Certifikatën e drejtimit të grupit kërkimor, etj.
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të CV-ve të personelit akademik GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe kompetencave që duhet të ofrojë programi. Gjithashtu gjatë bisedave me studentët dhe drejtuesit GVJ u informua që</p>

<p>ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>pedagogët përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies në varësi të tematikave apo profilit të vetë lëndës.</p> <p>Gjatë takimit me zyrën e Burimeve Njerëzore u informuam që institucioni i jep një rëndësi të madhe kritereve që aplikon në rekrutimin e personelit akademik. Sipas dokumentit “Mbi Politikat dhe Procedurat e Rekrutimit të Personelit Akademik Pika G.I.2 Kriteret” disa nga kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidatëve janë ato që lidhen me tregues të performancës së kandidatëve, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përvoja në mësimdhënie në nivel universitar, si dhe karriera profesionale jashtë auditorit; • Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke i dhënë përparësi universiteteve perëndimore; • Aftësitë komunikuese dhe etika; • Paraqitja gjatë leksionit të hapur para Departamentit përkatës, etj. 			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sipas Rregullores së UET Neni 22, institucioni përdor vlerësimin periodik të procesit mësimor me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë procesit të vlerësimit marrin pjesë jo vetëm drejtuesit e institucionit dhe të departamentit por edhe studentët.</p> <p>Studentët kryejnë vlerësim në fund të çdo semestri. Përveç pyetësorëve të vlerësimit studentët nëpërmjet fokus grupeve shprehin opinionet e mendimeve të tyre në lidhje me procesin mësimor dhe i diskutojnë në mbledhjet e hapura të departamentit ku më pas merren masa për të reflektuar ndryshimet e nevojshme dhe të miratuara nga drejtuesit dhe pedagogët.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Sipas Rregullores së UET Neni 18 pika 2 mësimizhvillohet në formë interaktive, duke integruar shpjegimin e pedagogut me diskutimet e studentëve. Këtë gjë GVJ e konstatoi edhe gjatë bisedave me personelin akademik, studentët dhe drejtuesit e departamentit dhe institucionit. Për ta bërë orën e mësimi sa më tërheqëse personeli akademik përdor metoda të ndryshme interaktive duke përfshirë edhe studentët në këtë proces.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në këtë mënyrë mësimi zhvillohet jo vetëm mbi bazën e shpjegimit të koncepteve thelbësore të lëndës por edhe diskutimeve midis grupeve të studentëve, zhvillimit të praktikave apo simulimit në laborator të programeve të ndryshme kompjuterike. Gjithashtu interaktiviteti dhe iniciativa e pavarur e studentëve shihet tek zhvillimi i detyrave të kursit dhe tek krijimi i grupeve online të bashkëpunimit, etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e




nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Referuar dokumentit Infrastruktura në Funkcion të Programit të Studimit si dhe gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se UET ka hapësira të mjaftueshme dhe cilësore në funksion të procesit mësimor të këtij programi studimi.</p> <p>Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni. Në funksion të këtij programi studimit janë edhe 4 Laboratorë Informatike, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor rreth 45 m²; • Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m²; • Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m²; • Lab 208 B me 80 PC (laboratori i internetit) rreth 160m². <p>Në dispozicion të lëndëve të lidhura me inovacionin, është vënë në dispozicion Laboratori “Inovation Hub”, i cili ndodhet në sallën 208, në katin e dytë të godinës A. Ky laborator ka një kapacitet prej 24 PC.</p> <p>Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal Wi-Fi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht web-in.</p> <p>Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së TI. Instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale. Në të njëjtën kohë programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentipërgjegjës për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Për realizimin e procesit mësimor personeli akademik dhe studentët përdorin laboratorët e informatikës/statistikës të cilët janë të pajisur me softwarë përkatës në mënyrë që t’i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Sistemet e operimit të instaluar janë Windows 7, paketa Microsoft Office 365 është instaluar e plotë me të gjithë softwarë e saj: Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PowerPoint; Publisher; SharePoint Workspace dhe Word.</p> <p>Për studentët që zhvillojnë programe të avancuara të informatikës, janë instaluar programet Navicat for my SQL, NetBeans, Apache Tom Cat. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës GVJ u njoh me literaturën bazë dhe ndihmëse në funksion të programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike”, me dy profile. Literatura bazë gjendet në libra ose leksione të printuar, të cilat kryesisht janë përkthime në gjuhën shqipe të pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi, ndërsa literatura ndihmëse gjendet kryesisht në gjuhë të huaj dhe është kryesisht në format elektronik. Studentëve i vihet në dispozicion çdo material që gjendet në bibliotekë ose fotokopje e leksioneve nga libraria e institucionit.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ mendon se literatura e printuar është e përshtatshme për marrjen e dijeve</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të</p>	

<p>mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhekomode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në këtë program studimi, por jo në një numër të madh dhe gamë të gjerë botimesh.</p> <p>Hapësirat e bibliotekës janë komode në një shtrirje prej 300 m², dhe oraret janë në përshtatje me nevojat e studentëve gjatë gjithë ditës deri në orët e vona të mbrëmjes.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës GVJ u informua se institucioni mbështet gjetjen e burimeve on-line të kërkuara nga pedagogët dhe studentët. Gjiithashtu UET ka bërë abonime në biblioteka virtuale online të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik mijëra tituj librash dhe artikuj shkencorë bashkëkohorë të tilla si Sage, Ebsco (abonim 5-vjeçar), Questia si dhe revista shkencore në hard copy të tilla si Harvard Business Review, The Economist, etj.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” me dy profile, GVJ u informua se mësimi zhvillohet kryesisht në 3 laboratorët (205B, 206B, 207B) që janë vënë në dispozicion të këtij programi studimi. Gjithashtu edhe salla e Lab 208B është gjithmonë në dispozicion të studentëve dhe zhfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme prej tyre, kryesisht për kërkime në internet në funksion të detyrave të kursit, projekteve, etj.</p> <p>Gjithashtu studentët mund të shfrytëzojnë aksesin në Internet në të gjitha ambientet e universitetit pa pagesë.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe në bazë të dokumentacionit të ofruar, GVJ u informua se UET në kuadër të plotësisht të rekomandimit të KA ka investuar në implementimin e një sistemi të qëndrueshëm për automatizimin e menaxhimit të studentëve dhe personelit, duke ofruar dy sisteme të automatizuara LMS dhe UMS, të cilat u vijnë në ndihmë si pedagogëve ashtu edhe studentëve për të shkëmbyer informacione në mënyrë të vazhdueshme duke i menaxhuar nga zyra, shtëpia apo telefoni aplikacionet në fjalë nga të dyja palët e interesuara. Pedagogët hedhin detyra, leksione, libra, pyetësorë apo shpallin njoftime kurse studentët i marrin njoftimet, shkarkojnë leksionet, librat, njoftohet mbi notat, pikët e përfutuara nga seminarët, detyrat e kursit, esetë, etj.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik, sekretaria dhe studentët i përdorin gjerësisht këto sisteme duke realizuar një komunikim në koherencë dhe të suksesshëm mes palëve. Institucioni kryen çdo vit trajnime të personelit dhe studentëve për përdorimin e këtyre platformave në mënyrë që të ketë ecuri pozitive të shfrytëzimit të tyre.</p> <p>Gjithashtu GVJ u informua se personeli akademik ka akses nëpërmjet intranetit të institucionit mbi Sistemin e Brendshëm Elektronik të Dokumentave të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe jo vetëm.</p> <p>Manual i përdoruesit të sistemit UMIS; Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS; UET-LMS guidë për pedagogun; UET-LMS guidë për studentin.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet</p>	<p>Rregullorja Mësimore e programit të studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” me dy profile, Pika 8përcakton që zgjedhja e temës së diplomës për studentët bëhet me ndihmën e pedagogut udhëheqës. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat</p>

në zhvillimin e tyre.	metodologjike prej 10 javësh në semestrin e dytë ku studenti njih hap pas hapi procedurën, teknikat dhe metodikën që duhet të ndjekë për të realizuar punimin e një diplome, sipas një kalendari takimesh të shpallur.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirëimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion se institucioni organizon struktura të posaçme për promovimin e përmirëimit të vazhdueshëm të mësimdhënies. Në këtë kuadër UET përfshin disa struktura të cilat janë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Këto struktura janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it; • Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe për monitorimin e zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit. • Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBCi cili nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET ka synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <p>Gjithashtu sipas Planit Strategjik 2015 – 2020 institucioni e ka në prioritetet e veta përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies.</p> <p>(Të dhëna për individët e angazhuar në KSBS; Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; Plani i Veprimit KSBC 2018-2019; Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2022).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstaton se njësia bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi dhe që kujdeset për dhe cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në të është Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit (që prej vitit akademik 2018-2019 e në vazhdim).</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të</p>	<p>Ky departament është përgjegjës për cilësinë e rekrutimit të personelit akademik, për cilësinë e sylabuseve të lëndëve, zhvillimin e procesit mësimor, zhvillimin e provimeve, etj. Departamenti zhvillon çdo javë mbledhje në të cilat diskutohen dhe ju jepet zgjidhje problematikave të</p>

<p>mësimdhënies.</p>	<p>ndryshme që lidhen me cilësinë e programin e studimit që ofron. Në këto mbledhje çdo muaj marrin pjesë edhe përfaqësues të studentëve të cilët çojnë kërkesat dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e procesit mësimor.</p> <p>GVJ gjatë bisedave me personelin akademik dhe studentët u informua se departamenti përgjegjës për këtë program studimi është suportues në zhvillimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies.</p> <p>(Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e dekanatit dhe departamentit; Rregullore e funksionimit të programit BA Informatikë Ekonomike)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ u informua gjatë vizitës në institucion nëpërmjet bisedave me personelin akademik që pedagogët mbështeten nga institucioni në procesin e kërkimit shkencor edhe nëpërmjet financimit të pjesmarrjes në konferenca apo të botimit të artikujve në revista të rëndësishme shkencore.</p> <p>Gjithashtu GVJ konstaton në bazë të Statutit të UET Neni 36 Pika 2 që institucioni garanton integritetin e veprimtarisë kërkimore-shkencore me atë të mësimdhënies, me qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie.</p> <p>Sipas Strategjisë së Kërkimit Shkencor në UET 2017 – 2020, institucioni e ka si objektiv strategjik të realizojë një mjedis stimulues të kërkimit shkencor për stafin akademik dhe studentët nëpërmjet:</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Standardizimit dhe ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor; • Strukturimit të një sistemi koherent të kërkimit shkencor dhe certifikimit të stafit akademik; • Trajnimit dhe certifikimit të aftësive të stafit akademik për të prodhuar dhe botuar dije origjinale shkencore; • Institucionalizimit të mëtejshëm të Projekteve të Mëdha Kërkimore (PMK) dhe grupeve kërkimore për rritjen e ndër-disiplinaritetit, maksimizimin e burimeve njerëzore, dhe shërbimin ndaj palëve të treta të interesuara në produktin shkencor të UET. <p>GVJ bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe RVB konstaton gjithashtu se institucioni në kuadër të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja kryen trajnime të vazhdueshme në lidhje me mësimdhënien, këshillimin në karrierë dhe kërkimin shkencor për personelin akademik por jo vetëm, të tilla si: “Si të jemi lektorë të suksesshëm”, “Si të publikojmë dhe hulumtojmë”, “Rregullat bazë të komunikimit dhe marketingut”, “Çfarë është edukimi”, “Çfarë do të thotë të menaxhosh”, “Zhvillimi i personelit akademik”, etj. (Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve)</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e</p>	<p>GVJ u informua gjatë bisedave me personelin akademik dhe drejtuesin e departamentit përgjegjës për këtë program studimi se departamenti është përgjegjës dhe i angazhuar plotësisht në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe testimin e metodave të reja alternative në funksion të përthithjes sa më mirë të njohurive nga studentët. Kjo gjë u pohua edhe në</p>

metodave të reja.	takimin me studentët të cilët informuan GVJ që stafi akademik përdorte metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe përçimit të materialeve didaktive tek ata. Sipas RVB dhe dokumentave të vëna në dispozicion kjo gjë bëhet kryesisht nëpërmjet sistemit LMS me anë të të cilit jo vetëm komunikohet me studentët për elementët e procesit mësimor por edhe gjenerohen raporte për aktivizimin e studentëve, për rezultatet, etj. Në fund të çdo viti akademik analizohen raportet e gjeneruara nga LMS dhe shikohen efektet e aplikimit të sistemit.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Institucioni ka përcaktuar në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Informatikë Ekonomike” Pika 5.2 kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Sipas kësaj rregulloreje GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar bëhet në varësi të tipologjive të lëndëve përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për lëndët e Tipologjisë I <ul style="list-style-type: none"> a. Provim përfundimtar (40%) b. Detyra praktike: $2 (dy) \times 30\% = (60\%)$ • Për lëndët e Tipologjisë II <ul style="list-style-type: none"> a. Provim përfundimtar (40%) b. Provim i ndërmjetëm (30%) c. Detyrë kursi (20%) d. Diskutime në seminare (10%) <p>Pika 2.6 e kësaj rregulloreje përcakton se në fillim të vitit akademik organizohet java orientuese, ku mbahen takime dhe leksione për shpjegimin e sistemit të studimeve, të rregulloreve dhe të procedurave administrative në UET, si dhe mbahen kurse parapërgatitore ekstra-kurrikulare.</p> <p>Studentët informohen në sistemet e platformave si UMIS, LMS apo me anë të postës elektronike në lidhje me format e vlerësimit dhe detyrimeve që duhet të përmbushin lidhur me to.</p>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe	GVJ konstaton se institucioni ka përcaktuar nëpërmjet Rregullores së UET mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe dijeve të marra gjatë procesit mësimor (Neni 24). Gjithashtu sipas kësaj rregulloreje përcaktohet se në rastin kur studenti ka aftësi ndryshe titullari i lëndës zgjedh formën më të përshtatshme të provimit (Neni 27). Në të gjitha rastet këto mënyra i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe

kompetencat e fituara.	kompetencat e fituara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Në bazë të dokumentit Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Informatikë Ekonomike” Pika 5.2 përcaktohet se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë vitit. Në varësi të tipologjisë së lëndëve vlerësimi përfundimtar bazohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për lëndët e Tipologjisë I <ul style="list-style-type: none"> a. Provimin përfundimtar (40%) b. Detyrat praktike: 2 (dy) x 30% = (60%) • Për lëndët e Tipologjisë II <ul style="list-style-type: none"> a. Provimin përfundimtar (40%) b. Provimin e ndërmjetëm (30%) c. Detyrën e kursit (20%) d. Nivelin e diskutimeve në seminare (10%)
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me procedurën e zhvillimit të provimeve për këtë program studimi si dhe shqyrtoi disa fletë të provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar të zgjedhura në mënyrë të rastësishme. Bazuar tek dokumentat e shqyrtuara gjatë vizitës si edhe tek Rregullorja Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Informatikë Ekonomike” Pika 5.3 GVJ konstatoi se provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Sekretimi i tezave përmes sistemit të barkodeve ofron sekretim të identitetit të studentit dhe paanshmëri të vlerësimit. Gjithashtu aplikimi i projektit Clean Score, i cili realizon korrigjimin e automatizuar të provimeve mundëson rritjen e besueshmërisë dhe transparencës në këtë proces.</p> <p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ shqyrtoi regjistrat, procesverbalet dhe dokumentat (modele tezash dhe procedura sekretimi) e tjera që lidheshin me studentët në këtë program studimi, bëri disa kontrole të rastësishme të notave sipas regjistrave, procesverbaleve apo sistemit elektronik dhe gjeti që të gjitha kishin përputhje me njëra-tjetrën. Gjithashtu gjatë bisedave me punonjësit e sekretarisë na u pohua që testimet zhvillohen me sekretim.</p>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	GVJ u informua nga drejtuesi i njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi se hartimi i tezave të provimeve të lëndëve dhe testimi i

profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	studentëve realizohet nga komisione prej dy anëtarësh ku njëri është titullari i lëndës. Këtë gjë GVJ e evidentoi edhe nga shqyrtimi i disa fletëve të provimeve që i zgjodhi në mënyrë të rastësishme nga arkiva e departamentit. E njëjta procedurë ndiqet edhe për testimin dhe vlerësimin e njohurive për lëndën e Praktikës Mësimore. Përsa i përket mbrojtjes së diplomës komisioni i vlerësimit përbëhet nga 5-7 anëtarë.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Gjatë vizitës në institucion në klasat ku zhvilloheshin provimet, GVJ konstatoi se institucioni siguron një infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe kamera sigurie për zhvillimin korrekt të të gjitha provimeve. Gjithashtu përcaktohet në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Informatikë Ekonomike” Pika 5.3.2 se provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Gjatë shqyrtimit të disa fletëve të provimeve të zgjedhura në mënyrë të rastësishme nga arkiva e departamentit si dhe nga takimi që GVJ pati me studentët dhe pedagogët e këtij programi studimi konstatoam që gjithmonë vlerësimi i provimeve shoqërohet me komente për të ndihmuar studentin të kuptojë sa ka arritur të përvetësojë nga lënda dhe çfarë duhet të përmirësojë. Vlerësimi me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Në bazë të Rregullores së UET Neni 33 njësia përgjegjëse dhe personeli akademik nuk e tolerojnë plagjiaturën dhe kopjimin nëpër provime dhe detyra të tjera. Gjatë bisedave me studentët dhe pedagogët e këtij programi studimi GVJ u informua se ata përpiqen të informojnë paraprakisht studentët edhe për rrjedhojat dhe saksionet e parashikuara nëse ky nen mund të shkelet.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ konstaton se vlerësimi i provimeve të studentëve bazohet gjithmonë mbi meritën e studentit dhe jepet në kohën e përcaktuar nga Rregullorja Mësimore e Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” Pika 5.3.4. Sipas kësaj rregulloreje dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të tyre, brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese, ku pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore.
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Sipas Rregullores Mësimore të Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” Pika 5.8 në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t’i drejtojë Drejtuesit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën.
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e	Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngrre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar.

<p>ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. Kjo procedurë është transparente dhe dokumentohet në arkivën e departamentit.</p> <p>Këtë gjë na e pohuan edhe studentët dhe pedagogët gjatë takimit që u zhvillua me ta në institucion, ku u informuam se kërkesat për rishikim dhe drejta për tu njohur me vlerësimin ju jepet studentëve për të gjitha aktivitetet që lidhen me procesin mësimor dhe vlerësohen me pikë të tilla si: kolokium, provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.7</p>	
<p>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Sipas dokumentit Rregullorë Mësimore e Programit të Studimit Bachelor “Informatikë Ekonomike” tek objektivat e programit përcaktohen thellimi i njohurive dhe zhvillimit i aftësive profesionale të veçanta të teknologjisë së informacionit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>GVJ konstaton se një pjesë e konsiderueshme e lëndëve që ofrohen në këtë program studimi ofrojnë më së shumti njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit, por edhe aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale, aftësi të përgjithshme praktike dhe aplikative, formim qytetar të përgjithshëm; aftësim për promovim personal, etj. Konkretisht disa nga specifikat e programit të studimit janë të ofrojë aftësi në përdorimin dhe administrimin e rrjetave, të mjeteve dhe mënyrave të transportit, të përpunimit të zërit, të të dhënave dhe të figurës, për të ofruar aplikime dhe shërbime komunikuese multimediale në kohë reale, transaksione bankare të sigurta, etj.</p> <p>Gjithashtu në këtë program studimi programi i lëndës hartohet në përputhje me tekstin bazë, i cili është zakonisht një tekst i mirënjohur ndërkombëtarisht në fushën përkatëse të studimit i përkthyer në gjuhën shqipe. (Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës, A III. 4.1).</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumenti “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës Pika A III.1, A III.2, A III.4.1” pedagogu i lëndës i prezanton studentët që në fillim të semestrit me programin, objektivat, kompetencat dhe aftësitë që pritet të fitojë studentit gjatë zhvillimit të lëndës. Në fund të semestrit gjithashtu këto elementë shqyrtohen dhe analizohen përsëri për të vënë në dukje arritjet e studentëve dhe pikat ku ata duhet të punojnë më shumë.</p>

<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>GVJ u informua gjatë bisedave në institucion me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi se në përfundim të çdo lënde pedagogu i orienton studentët për provimin, çështjet më të rëndësishme ku duhet të bazohen, i ofron konsultime sipas nevojave dhe kërkesave të tyre në mënyrë që ata të jenë sa më të qartë për përmbajtjen dhe zhvillimin e provimit përfundimtar.</p> <p>Nga ana tjetër disa prej lëndëve janë të lidhura me njëra – tjetrën ku njohuritë e njëjës implementohen apo zbatohen gjatë zhvillimit të lëndës pasardhëse, të tilla si Algoritmikë dhe Hyrje në Programim, Programim 1 e Programim 2 (Syllabuset e lëndëve përkatëse).</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua nga drejtuesit, pedagogët dhe studentët se në funksion të këtij programi studimi por jo vetëm, institucioni ofron periodikisht leksione të hapura për çështje të rëndësishme të teknologjisë dhe biznesit. P.sh. orë të klubit të IT apo pjesë të forumeve e ëorkshopeve të ndryshëm, ku studentët kanë mundësinë e zgjerimit të dijeve dhe prezantimit me risi të reja në fushën e teknologjisë. Leksione të hapura zhvillohen edhe nga ekspertë të njohur të fushës nga institucionet partnerë brenda dhe jashtë vendit, si dhe bizneset më të suksesshme me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumenti “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës, A.III.3. Format e zhvillimit të procesit mësimor dhe A.III.4.1.2. Metoda pedagogjike” si dhe bisedat me studentët dhe pedagogët GVJ konstatoi se mësimdhënia dhe mësimnxënia realizohet mbi bazë kompetencash në mënyrë që t'u japë studentëve mundësinë të zhvillojnë njohuritë e marra në laborator dhe praktikat profesionale.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Këto njohuri përfshijnë aftësi për të kuptuar funksionimin dhe ndërtimin e Sistemeve të Informacionit, për të kuptuar dhe analizuar funksionimin e rrjetave kompjuterike, për të kuptuar parimin e funksionimit të pajisjeve kompjuterike dhe Internetit, etj. Me qëllim që studentët të aplikojnë këto njohuri gjatë zhvillimit të praktikave profesionale, institucioni ka një sërë marrëveshjesh me kompani të njohura të TI në vend.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Gjithashtu pedagogët motivojnë studentët të zhvillojnë sa më shumë diskutime dhe të punojnë në grup gjatë procesit mësimor. Studentët inkurajohen gjithashtu të marrin pjesë edhe në konkurse të ndryshme për të shpalosur idetë e tyre novatore. Nuk ka informacione që të pasqyrojë angazhimin e studentëve të këtij programi studimi në studime të avancuara kërkimore e shkencore.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Institucionindjek një politikë të mbështetjes së ideve inovative dhe i motivon e promovon ato tek studentët duke ofruar edhe mbështetjen financiare. Sipas RVB dhe dokumentave të vëna në dispozicion GVJ konstaton aktivitete të tilla si Shkolla Dimërore e Inovacionit 2019 apo thirrjet për pjesëmarrje në konkurse për propozim idesh, të organizuara nga UET.</p>

<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Sipas Planit Strategjik 2015 – 2020 të UET një nga prioritetet strategjike është bashkëpunimi me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit me qëllim rritjen e mobilitetit të studentëve, shembull i mirë janë bursat Erasmus të mobilitetit.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në këtë proces ka pasur Zyra e Projekteve e cila realizon gjithë procesin që nga shpërndarja e thirrjeve për këto bursa deri tek intervistimi dhe shpallja e studentëve përfitues të tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentëve ju bëhet e qartë procedura për provimin final ose mbrojtjen e diplomës nëpërmjet Rregullores së UET, Neni 39; Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Informatikë Ekonomike”, Pika 8; si dhe dokumentit “Mbi punimin e diplomës/disertacionit”. Studentët njihen me këto dokumenta që në fillim të vitit përkatës akademik.</p> <p>Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi me kërkesë të studentit për studentët me notë mesatare së paku 8.5, ose nëpërmjet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP) (Rregullore e UET Neni 39).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Gjatë takimeve me drejtuesin e departamentit, pedagogët dhe studentët GVJ u informua se studentëve ju vihen në dispozicion të gjitha materialet e nevojshme sqaruese për mbrojtjen e diplomës apo në lidhje me provimin final nëpërmjet platformave LMS dhe UMIS të sistemit e-learning. Nëpërmjet këtij sistemi studentëve ju jepet grupi i pyetjeve orientuese për secilën kategori lëndësh dhe zhvillohen seanca sqaruese një ditë përmbledhëse ku çdo pedagog shpjegon çështjet që lidhen me lëndën e tij dhe ku studentët duhet të fokusohen më shumë. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike që zhvillohen si orë seminaresh, sipas një kalendari takimesh, të shpallura (referuar dokumentave Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Informatikë Ekonomike”, Pika 8; Mbi punimin e diplomës/disertacionit, Pika BII.6.1).</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që nëse studentët e mbrojnë diplomën nëpërmjet një provimi të përgjithshëm përfundimtar ky provim do të bazohet mbi lëndët më të rëndësishme që karakterizojnë programin e studimit dhe profilin përkatës (Rregullore e UET Neni 39). Kjo gjë vendoset nga komisioni i posaçëm që krijohet nga pedagogët e lëndëve, koordinatori i programit dhe</p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>përgjegjësi i departamentit. Studentëve ju jepen paraprakisht pyetjet orjentuese për secilën kategori lëndësh duke i informuar edhe për peshën specifike të tyre dhe duke dhënë sqarimet e nevojshme në lidhje me çështjet ku ata duhet të përqëndërohen.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në rastin kur diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi apo kërkimore kjo bëhet me kërkesë të studentit, për studentët me notë mesatare së paku 8.5 e përcaktuar në Rregulloren e UET Neni 39. Në këtë rast institucioni dhe pedagogu udhëheqës e mbështet studentin në realizimin e studimit të tij i cili për programin e studimit Bachelor përqendrohen kryesisht në një rast teorik, ku studenti aplikon një model teorik ose bazohet tek një koncept për të shpjeguar një aspekt të realitetit empirik.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur të cilat janë orë në auditor, konsiderohen formalisht si orë seminaresh, që kanë për qëllim të ndihmojnë studentët të përpunojnë aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës (B.II.5). Gjatë këtyre seancave udhëheqësi asiston studentin në realizimin e temës.</p> <p>Pedagogu drejtues i seancave metodologjike pranon, vlerëson dhe paraqet në Sekretarinë Mësimore dosjen e strukturave të punimeve të studentëve që marrin pjesë në këto seanca (B.II.5.4.). Sipas Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit Parë Bachelor “Informatikë Ekonomike”, Pika 8.4 studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit Parë Bachelor “Informatikë Ekonomike”, Pika 8.7 studenti në përfundim të provimit ose të mbrojtjes së diplomës vlerësohet me notë. Nëse nota është kaluese ai përfiton 7 kredite ECTS.</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Sipas Rregullores së UET Neni 40 studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj UET-it dhe ka përmbushur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni brenda 6 muajsh me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në UET, me suplementin e diplomës, të firmosura nga Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm.</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Sipas dokumentit “Mbi punimin e diplomës/disertacionit, Pika B.II.15.2.” Sekretaria Mësimore harton dhe e pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).</p> <p>Gjithashtu sipas RVB dhe informacionit që morëm në institucion GVJ u informua se: në përfundim të studimeve studenti ka të drejtë të kërkojë të marrë një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të</p>

	studimit të zhvilluar.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Sipas dokumentit “Mbi punimin e diplomës/disertacionit, Pika B.II.15.3” çdo diplomë, përpara se të lëshohet nga UET-i, regjistrohet sipas legjislacionit në fuqi. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua nga drejtuesit e këtij programi studimi se institucioni ruan në zyrën e kontratave për një periudhë 2 vjeçare kopje të dokumentacionit të studentit, dhe pastaj për një periudhë të pacaktuar i ruan në arkivë dhe i paraqet sipas rastit informacionet për studentin nëse kërkohen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.	Zyra e Burimeve njerëzoremban dokumentacion të plotë dhe të përditësuar për çdo anëtar të personelit të angazhuar në këtë program studimor, si dhe për çdo anëtar të stafit administrativ e atij ndihmës. Dosja e anëtarit të stafit akademik përfshin diplomat, certifikatat e ndryshme, vërtetimet për gradat akademike, CV-të, kontratat, vlerësimi akademik etj., të dhëna këto që përditësohenvazhdimisht. Zyra e Burimeve Njerëzore disponon një bazë të dhënash ku përfshihet ngarkesa mësimore e stafit të angazhuar në këtë degë studimi, sipas semestrave dhe vitit akademik.
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik janë specifikuar nëKreu V, Neni 44 i statutit, si dhe nëRregulloren e Burimeve Njerëzore në G.1, të cilat janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Për efekt të rekrutimit të personelit, në përputhje me statutin dhe rregulloren, mblidhet një komision rekrutimi me kompetencë të plotë për përzgjedhje stafi, i cili interviston secilin kandidat të interesuar për punësim pasi ka shqyrtuar më parë dosjen e plotë të dorëzuar paraprakisht pranë zyrës së Burimeve Njerëzore;

<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kriteret e rekrutimit përcaktohen nga njësia bazë në bazë të nevojave të saj dhe miratohen nga rektori (Statuti, Kreu V, Neni 44). Procedura dhe rregullat e punësimit përcaktohen bazuar në aktet nënligjore në fuqi, dhe aktet rregullatore të UET. Më në detaje këto kritere, rregulla e procedura janë specifikuar në Rregulloren e Burimeve Njerëzore. Ato bëhen publike kur shpallen pozicionet vakante.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në përgjithësi ndjek procedurat për rekrutim dhe vlerësim mbështetur edhe në kritere të vendosura nga baza ligjore në fuqi, statute dhe rregullorja e burimeve njerëzore. Procedura e rekrutimit dhe vlerësimit mbështetet në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>Seleksionimi paraprak realizohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila i kalon çdo Departamenti kandidaturat që plotësojnë kritere të konkurrimit dhe që kanë profil akademik në përputhje me nevojat e përcaktuara nga Departamenti për personel të ri. Bazuar në Rregulloren e Burimeve Njerëzore (G.I.10.1, G.I.10.2 dhe G.I.10.3.) departamentet përzgjedhin kandidatët që do të kalojnë në fazën e intervistës. Për personelin akademik me kohë të plotë, kontrata nënshkruhet me kohëzgjatje të caktuar ose me kohëzgjatje të pacaktuar, sipas përcaktimeve në Statutin e UET. Për personelin akademik të angazhuar me kohë të pjesshme, kontrata lidhet njësemestrale ose vjetore me të drejtë përsëritje sipas vullnetit të palëve. Kontratës së punës i bashkëngjitet edhe formulari për Aktivitetin Akademik, i cili përditësohet në fillim të çdo viti akademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;">X</p>				

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efektive dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga vizita e GVJ, si dhe nga Raporti Vjetor 2017-2018, Seksioni B, pika f: Të dhëna për infrastrukturën dhe mjediset didaktike në funksion të mësimin, konstatohet se institucioni ofron kushte të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit si p.sh. zyra të përshtatshme dhe të pajisura me mjetet e duhura, laboratorë për zhvillim të mësimdhënies dhe projekteve të tyre, pajisje teknike, etj.</p> <p>Për të mundësuar kryerjen sa më të mirë dhe me profesionalizëm të detyrave të personelit akademik, realizohen trajnime rreth metodave të reja të mësimdhënies për stafin ekzistues. Nëstatutin e UET është</p>

	specifikuar në Kreu V, Neni 44/3 , se personeli akademik i nënshtrohet në mënyrë periodike trajnimeve, testimeve e vlerësimeve të performancës. Për stafin e ri ofrohet trajnim përkatës për fillim në jetën akademike, ku ndër të tjerat përfshihet edhe ndjekja e leksioneve të pedagogëve me përvojë në lëndët ku ata janë të angazhuar si asistentë.			
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Përveç trajnimeve të përmendura më sipër, institucioni nxit kualifikimin e vazhdueshëm të personelit duke ofruar grante për zhvillim dhe publikim të rezultateve nga kërkimet e tyre shkencore, si dhe duke vendosur procedura të pikësimit për arritjet e tyre. Aksesit në biblioteka prestigjioze online është gjithashtu një faktor i rëndësishëm për rritjen e vazhdueshme profesionale, kryesisht nëpërmjet mundësisë përditësimin e njohurive e teknikave profesionale sipas programit të studimit.			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Bazuar në evidencën e ofruar nga institucioni (43. Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin) institucioni është i përkushtuar në ofrimin e trajnimeve dhe workshop për përditësimin e teknikave të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive bashkëkohore, si në mësimdhënie edhe në kërkim shkencor.			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Mbështetja e institucionit për trajnime dhe kërkimin shkencor, ka si objektiv primar përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni zhvillon gjithë aktivitetin e tij në kampusin kryesor të përbërë nga dy godina kryesore, duke siguruar kështu mjediset e mjaftueshme për zhvillimin e mësimdhënies për këtë program studimi. Brenda kampusit gjendet edhe biblioteka që ofron hapësirë të bollshme për studentët. Brenda kampusit ndodhen 4 laboratorë informatike, në të cilat operojnë rreth 180 kompjutera, dhe ku realizohenorët praktike.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e	Sipas dokumentit “Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit”, dhe sipas konstatimit të GVJ gjatë vizitës në institucion, rezultojnë se mësimi i programit studimor zhvillohet në 4 salla mësimdhënies si vijon: <ul style="list-style-type: none"> • Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor rreth 45 m²

teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<ul style="list-style-type: none"> • Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m² • Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m² • Lab 208 B me 80 PC (laboratori i internetit) – 160m² 								
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Bazuar në inspektimin e GVJ, të gjitha sallat në të cilat zhvillohet mësimdhënia janë të pajisura me kompjutera dhe projektore funksionale, video projektore dhe mjete të tjera audio vizive, të cilat ofrojnë mundësi të kuptimit më të mirë të lëndëve dhe realizimit më praktik të tyre. Një prej këtyre laboratorëve ka edhe një tabelë interaktive. Në kompjutera instalohen software që nevojiten për zhvillimin e mësimdhënies, gjë që kryhet nga Zyra e Teknologjisë së Informacionit. I gjithë ambienti universitar është i mbuluar me sinjal Wi-Fi me qëllim qasjen në internet në çdo kohë nga ana e studentëve dhe personelit.								
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Institucioni zotëron disa labore të teknologjisë së informacionit, me parametra të nevojshëm për sigurim cilësor të mësimdhënies. Një nga laboratorët disponon edhe me tabelë interaktive, ndërsa një tjetër përmban pajisje hardware, që përdoren për mësimdhënie dhe demonstrim në lëndët që kanë të bëjnë me hardwares.								
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Institucioni ka akomoduar një pjesë të praktikave pranë njësive të tij administrative, si biblioteka, zyra e IT, zyra e karrierës, zyra e aktiviteteve, etj. Pjesa tjetër akomodohen pranë kompanive të ndryshme, me të cilat universiteti ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për këtë qëllim (Shiko Ref.35. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf)								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	GVJ vizitoi bibliotekën e institucionit, e cila është në dispozicion të studentëve për mësim dhe literaturë. Biblioteka zotëron gjithsej 6005 tituj të disponueshëm për studentët, nga këto në shqip janë 4634 tituj dhe në gjuhë të huaj 1371, kryesisht anglisht. Përveç kësaj ofrohen edhe libra elektronikë për të gjitha lëndët e programit studimor, kjo edhe për shkak të zhvillimit shumë dinamik të fushës dhe nevojës për literaturë sa më të përditësuar (Inventari i teksteve). ¹

¹Evidenca Nr. 45

<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Përveç librave fizikë dhe ambientit (të përmendur më sipër), biblioteka ofron edhe akses online për studentët, kryesisht për punime shkencore si biblioteka Questia, Sage, EBSCO etj.</p> <p>Botimet periodike në të cilat është abonuar institucioni, në total janë 162, nga këto 102 janë në shqip dhe 60 janë në gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, italisht).</p> <p>Vihet re mungesa e literaturës në gjuhën shqipe veçanërisht për lëndët e informatikës, gjë që u konfirmua nga të intervistuarit gjatë vizitës në institucion. Librat në programim janë në gjuhë të huaj. Studentet përdorin literaturë në anglisht, po në përgjithësi për këtë degë, pedagogu përgatit leksione të parashkuara për lëndën dhe rekomandon materiale orientuese në gjuhën shqipe.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Akresi në bibliotekat online të fushës së studimit, abonimi për të cilat është vjetor dhe aktiv, është pa pagesë për studentët.</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me kompjutera dhe programe kompjuterike. Në bibliotekë janë instaluar 14 PC nëpërmjet të cilëve studentët aksesojnë bibliotekat on-line (Raporti vjetor 2017-2018). Studentët kanëqajse pa kufizime në bibliotekën online.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Institucioni ka pasuruar vazhdimisht bibliotekën me tituj të rinj në mbështetje të programeve të studimit. Nuk ka evidencë për njëplan të detajuar apo politikë të shkruar për mënyrën se si bëhet pasurimi i bibliotekës me tituj. Gjatë vizitës, u konstatua se përditësimi/pasurimi bëhet në bazë të interesit apo kërkesave të pedagogëve dhe studentëve për tituj të caktuar.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon nga 9:00 deri në 20:00 (gjatë ditëve të javës) dhe ditën e shtunë 9:00:17:00. Gjatë sezoneve ofrohen orare më të zgjatura për mësim nga studentët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë</p>	<p>Institucioni ka ndërtuar sistemin për menaxhimin e studentëve, ku studentët regjistrohen që në momentin kur pajisen me ID dhe email institucional (Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS, Manuali i</p>

informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	përdoruesit të sistemit UMIS, LMS-Guidë për studentët). ² Ky sistem regjistron të dhënat që kanë të bëjnë me studentët gjatë gjithë ciklit të tyre në institucion që përfshin vendosjen dhe leximin e notave, orareve, aktiviteteve të ndryshme deri në momentin e diplomimit. ³			
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i brendshëm lejon akses edhe për pedagogët dhe personelin administrativ, ku ata mund të vendosin dhe marrin informacion. Notat finale dorëzohen nga pedagogët në procesverbale, dhe vendosen online nga sekretaria.			
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Aksesi në sistem është i dedikuar në bazë të grupit të përdoruesit, p.sh., studentët mund të shohin vetëm notat individuale, jo notat e të tjerëve.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Zyra IT është mjaft e angazhuar në integrimin e moduleve të ndryshme nga sistemi për menaxhimin e mësimdhënies me sistemin për menaxhimin e studentëve, me qëllim informimin në kohë reale të studentëve me ecurinë e tyre në procesin mësimor dhe shkëmbimin e informacioneve të tjera (ndarje detyrash, materialesh të kursit, lajmërimi, etj.) mes studentëve e pedagogëve.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Përveç moduleve për integrim, janë vendosur edhe module për raportime të ndryshme si p.sh., raportime nga vlerësimet online të studentëve. Me këtë sigurohet edhe monitorimi dhe raportimi i punës së personelit akademik për drejtuesit dhe menaxhmentin e institucionit në kohë reale.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me aktivitetet e ndryshme janë të publikuara në faqen e internetit, por vetëm në gjuhën shqipe. Menu është në gjuhën angleze, që do të thotë që janë bërë përpjekje që të përmbushet ky kriter.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

²Evidenca Nr. 46, 46.1, 46.2, 46.3

³ Shiko Evidencën Nr. 46, 46.1, 46.2, 46.3

<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga Raporti i Vlerësimit Të Brendshëm rezulton se institucioni, çdo vit, harton një raport financiar të kostove dhe planin për mbështetje financiare të programit të studimit. Plani përmban një raport të drejtë të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe këto raporte gjenden në Zyrën e Financës (Të ardhura dhe financime të ndryshme).⁴</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Buxheti financiar hartohet në fillim të çdo viti akademik dhe miratohet nga aksioneri i institucionit. Të ardhurat e institucionit janë, në shumicën e tyre, ato të siguruar nga tarifat e studimit që paguajnë studentët. Ka edhe financime nga projekte në të cilat merr pjesë institucioni, por këto janë më pak të zakonshme.</p> <p>Përgjegjësinë për menaxhimin financiar e ka Administratori dhe Zyra e Financës.</p> <p>Plani i buxhetimit të programit të studimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas Statutit të UET, Kreu VIII, neni 54, pika 5 dhe 6,⁵ institucioni i nënshtrohet çdo vit auditimit nga ekspertë financiarë. Raportet financiare përmbajnë një pasqyrë të qartë të situatës financiare për përdorimin e të ardhurave të grumbulluara nga shërbimet që ofron institucioni në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe planifikon financimin e programit të studimit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij (Të ardhura dhe financime të ndryshme).⁶</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe</p>	<p>Institucioni dëshmon se ka qëndrueshmëri financiare gjatë zhvillimit të programit të studimit. Kjo evidentohet edhe nga bursat e ekselencës që ofrohen për studentë me mesatare të lartë.</p>

⁴Evidenca Nr. 50.

⁵Evidenca Nr. 2

⁶Evidenca Nr. 50.

gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni ka hartuar gjithë procedurat e nevojshme që mbulojnë ciklin e studimit nga regjistrimi deri në diplomim, ku përfshihen Rregullorja Akadematike, Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit, Rregullore e programit të studimit BA Informatike Ekonomike. ⁷
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Për kandidatët garantohej trajtim i barabartë që nga regjistrimi në program, deri në mbyllje të studimeve.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve janë të vendosura në rregulloren e programit studimor, si për studentët që regjistrohen për herë të parë, ashtu edhe për ata që transferohen nga ndonjë institucion tjetër. Gjithashtu, informacioni i përgjithshëm për aplikimet dhe pranimet është i disponueshëm në faqen e internetit të Universitetit (http://uet.edu.al/new/aplikimet-dhe-pranimet/).
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Institucioni përmbush detyrimet ligjore, pasi përzgjedhja e studentëve për këtë program studimi bëhet në bazë të meritës nga Matura Shtetërore.
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si	Nuk ka kritere shtesë të vendosura nga Universiteti për këtë program studimi. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen kriteret e pranimit në programin e studimit, të përgjithshme. Ky informacion

⁷Evidenca Nr. 7

dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	është i disponueshëm edhe në faqen e internetit.			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Gjatë vizitës në UET u informuam se, bazuar në Rregulloren e UET, KREU VIII, Neni 36 institucioni ndërmerr fushata informimi me maurantët e shkollave të mesme për degët e studimeve që ofron dhe mundësitë që u jep ky institucion, mundësitë për bursa, akses të lehtësuar në programe të ndryshme studimi me anë të mbështetjes së plotë apo të pjesshme të kostove të studimit, prezanton stafin pedagogjik, kriteret e pranimit, mënyrën e aplikimit, etj. Gjithashtu, institucioni ka hartuar edhe Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online. ⁸			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Sipas RVB, institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në tjetrin. Sistemi i brendshëm informatik mundëson që studentet të kenë gjithnjë akses në informacionin mbi numrin e krediteve të përfutur prej tyre.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në faqen e internetit të UET, përveç kriterëve të pranimit, janë të publikuara edhe kriteret e transferimit dhe lista e dokumentave që kërkohet për transferimin dhe njohjen e kualifikimeve, apo krediteve të mëparshme të marra nga institucione të tjera të arsimit të lartë.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve në fillim të çdo semestri për çdo lëndë veçmas duke u vënë në dispozicion syllabuset e lëndëve dhe duke u dhënë sqarim shtesë nga ana e pedagogëve përkatës.
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	UET ka një Rregullore të diplomimit ⁹ nëpërmjet të cilit studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit. Studentëve u vihet në dispozicion rregullorja e programit të studimit dhe u jepen sqarime shtesë nga ana e pedagogëve udhëheqës.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të	Të interesuarit informohen në mënyrë periodike nëpërmjet udhëzuesve të ndryshëm, ditëve të hapura dhe uebit në lidhje me programet e

⁸Evidenca Nr. 48.

⁹Evidenca Nr. 10

posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	studimit për të cilin ata janë të interesuar. Institucioni ndërmerr fushata informimi me maturantët e shkollave të mesme për degët e studimeve që ofron dhe mundësitë e financimit që u jep ky institucion. ¹⁰			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënimit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Që në fillim të studimeve studentët janë të informuar për kohëzgjatjen e studimeve konform bazës ligjore në fuqi. Gjithashtu informohen për strukturën e programit studimor, shoqëruar me informacionin rreth përmbajtjes së lëndëve/moduleve. Gjithë ky informacion u vihet në dispozicion edhe online, nëpërmjet platformës për menaxhim të mësimdhënies që në javën e parë të vitit akademik.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Informacioni mbi modulet/lëndët, semestrin kur kryhet lënda dhe kreditet e secilës lëndë, janë të disponueshme në faqen e internetit të UET. ¹¹ Informacione të mëtejshme mbi përmbajtjen e lëndës gjenden në syllabuse, të cilat vendosen në dispozicion të studentëve në fillim të modulit, apo në çdo kohë tjetër me kërkesë të tyre.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Në UET funksionon Zyra e Karrierës, e cila orienton si në përzgjedhjen e degëve edhe në mundësitë e punësimit. GVJ konstatoi një bashkëpunim të mirë të institucionit me botëne biznesit. Për të patur qasje më të lehtë në tregun e punës, si dhe për të patur feedback për kompetencat e studentëve pas diplomimit krahasuar me nevojat e tregut, në përputhje me Statutin e UET, Neni 18.1, janë formuar edhe Bordet e punës që kanë 11 anëtarë, ku shumica janë ish-studentë të institucionit. Me ndihmën e bordeve të punës dhe kontratave të lidhura më kompani nga bota e biznesit janë realizuar mjaft internshipe me kompani partnere. Studentët janë vazhdimisht të informuar rreth mundësive të ndryshme për internshipe. Studentët vazhdojnë të disponojnë me emailin institucional edhe si alumni dhe në këtë mënyrë arrijnë të informohen për mundësi punësimi edhe pas diplomimit. Emaillet informuese janë të

¹⁰<http://uet.edu.al/new/aplikimet-per-ne-universitet-nuk-dini-cfare-dege-te-zgjidhni-uet-ju-vjen-ne-ndihme-me-keshillim-karriere/>

¹¹<http://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2018/10/BA-Menaxhim-Biznesi.pdf>

<http://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2018/10/BA-Finance.pdf>

	vazhdueshme nga Zyra e Karrierës, në varësi të vendeve të lira të internship apo të punës që ofrojnë kompanitë partnere. Këto emaille mundësojnë edhe gjurmimin e studentëve për prodhimin e analizave të punësueshmërisë së studentëve (Referuar dokumentit “Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve”. ¹²			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Kur fillojnë studimet, studentët informohen mbi organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet ndaj studentit. Sipas RVB, çdo ndryshim në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij, u njoftohet studentëve përmes njoftimeve të koordinatoreve të departamenteve dhe shpallet në këndin e njoftimeve. Sipas “Udhëzuesit për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit”, çdo informacion në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UET, dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemit LMS. ¹³			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Studentëve, që në fillim, u alokohet një email institucional, regjistrohen në sistemin për menaxhimin e mesimdhënies dhe sistemin për menaxhimin e studentit. Me ndihmën e këtyre kanaleve ata informohen për elementet e reja dhe përditësimet në procesin e përgjithshëm gjatë ciklit të tyre të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nëse përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Institucioni disponon me statistika për numrin e të diplomuarve, që verifikohet lehtë nga regjistri themeltar, i cili iu vu në dispozicion GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, në institucion.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet	Institucioni disponon statistika për numrin e studentëve të regjistruar në programin studimor, dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit (Të dhëna tabelore për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve). ¹⁴ Edhe këto statistika janë lehtësisht të verifikueshme me ndihmën e regjistrimit themeltar. Sipas të dhënave të verifikuara nga GVJ edhe në regjistrin themeltar

¹² Evidenca Nr. 17.

¹³ Evidenca Nr. 46

¹⁴ Evidenca Nr. 27

<p>programi i studimeve.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Në 2017-2018 u regjistruan në vit të parë 138 studentë, dhe bashkë me transferimet, ishin gjithsej 176 studentë. ▪ Në 2018 – 2019 kaluan në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe në 2019-2020 kaluan përsëri në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. ▪ Në 2017 -2018 kishte 108 studentë të regjistruar në profiling Financë-Bankë, dhe 19 prej tyre janë larguar. ▪ Në vitin akademik 2017 -2018 kishte 68 studentë në Menaxhim Biznese, dhe 13 të larguar. <p>Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve ciklit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre, duke përdorur regjistrin e notave dhe procesverbalet e provimeve.</p> <p>Aktualisht, janë 144 studentë të regjistruar në degë.</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ, u demonstrua verifikimi i të dhënave të studentit duke kontrolluar studentë të rastit nga regjistri themeltar.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në bazë të RVB dhe dokumentacionit të dorëzuar për të dhëna për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, si dhe të dhënat për punësimin real të studentëve, GVJ konstaton se institucioni harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje,¹⁵ dalje dhe tregun e punës.¹⁶</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi V.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe</p>	<p>Sipas Statutit të UET, Kreu VII, neni 51, studentët kanë qeverinë e tyre, nëpërmjet së cilës ata janë të përfaqësuar në organet vendimmarrës të institucionit sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p> <p>Institucioni garanton përfaqësimin e studentëve në vlerësimin e</p>

¹⁵ Referuar dokumentit “Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje” (Ref. Nr. 27)

¹⁶Referuar dokumentit ”Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve” (Ref. Nr. 17)

<p>atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>përgjithshëm të procesit akademik kryesisht nëpërmjet fokus grupeve dhe sondazheve të cilat bëhen në fund të çdo semestri akademik. Sondazhet bëhen online dhe si të tilla janë lehtësisht të verifikueshme dhe të matshme. (F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, pika F.VII.4.3)</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përveç përfaqësimeve të mësipërme, një përfaqësi studentësh janë të lejuar të marrin pjesë edhe në mbledhjet e departamentit dhe të japin inputet e tyre në lidhje me procesin, performancën aktuale dhe mundësitë e përmirësimit të tyre.</p>			
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Gjatë hartimit të programit studimor merren në konsideratë gjithë rekomandimet për ngarkesën akademike të studentëve në auditor dhe mësim jashtë auditorit sipas parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi. Për këtë arsye është vendosur edhe një template si për programet studimore, ashtu edhe për organizimin e moduleve ku janë të vendosura qartë ngarkesat përkatëse në orë sipas krediteve (Formati i Syllabusit Cikli i parë dhe dyte (A1)).¹⁷</p> <p>E njëjta vlen edhe për njohjen e krediteve nga studime të mëparshme - bëhen llogaritë për transferime dhe lejohet kalimi nga një vit në tjetrin konform parashikimeve ligjore në fuqi (Rregullore mësimore e programit të studimit të ciklit të parë, bachelor “Informatikë Ekonomike”, pika 9).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët japin feedback-un e tyre në lidhje me programin e studimit, organizimin dhe përmbajtjen e tij. Ata kanë të drejtë të rishikojnë provimet e të ankimojnë rezultatet (Rregullore mësimore e programit të studimit të ciklit të parë, bachelor “Informatikë Ekonomike”, pika 5.8).</p> <p>Komentet dhe sugjerimet e studentëve pastaj merren në konsideratë gjatë rishikimit të programeve mësimore dhe përmbajtjes së moduleve, si dhe angazhimit të personelit akademik në vitet pasuese.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët vlerësojnë performancën e pedagogëve online në fund të semestrit. Përveç kësaj ata japin komentet dhe sugjerimet e tyre në lidhje ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e personave përgjegjës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i plotë</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

¹⁷Evidenca 19.2.

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	Sipas Evidencës Nr. 5, “Rregullore e UET”, në UET funksionon Zyra e Kujdesit ndaj Studentit ¹⁸ si dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës ¹⁹ . Të dyja këto zyra, asistojnë studentin që nga regjistrimi deri në diplomim, ofrojnë informacion e këshillim për çështje të lidhura me procesin akademik dhe përfshirjen e studentëve në tregun e punës, përzgjedhjen e karrierës dhe vendin ku do të kryejnë praktikën, etj. Një këshillues karriere funksionon në çdo department.			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	UET ofron një shërbim shumë të mirëtë këshillimit në karrierë nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës (Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit). ²⁰ Kjo zyrë angazhon personelin akademik në dhënien e këshillave mbi zgjedhjen e programeve të studimit, si në nivel master edhe bachelor. Zyra ofron këshillim karriere, ndjek progresin akademik të studentëve dhe përfshirjen e tyre në tregun e punës.			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	Zyra e këshillimit të karrierës çdo vit kryen gjurmimin e studentëve të diplomuar një vit më parë për të hartuar raportin e punësueshmërisë së studentëve (Të dhëna Tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve). ²¹			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

¹⁸ Kreu IV, neni 22, pika 2b (Ref. Nr. 5)

¹⁹ Evidenca Nr. 12, 12. E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf

²⁰ Evidenca Nr. 12

²¹ Evidenca Nr. 29,

				X
--	--	--	--	---

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në strukturën e institucionit ekzistojnë procedura dhe politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë sipas parashikimeve ligjore e përcaktimeve nënligjore në fuqi për këto programe studimi. Gjithashtu, ka një Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ²² dhe një Strategji për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022. ²³
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Brenda strukturave të institucionit ushtron veprimtarinë njësi e posaçme që ndjek strategjinë për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve <i>ad hoc</i> , dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit (Statutit i UET, Kreu II, nen 16). ²⁴ Komisioni i kushton vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë, për të garantuar që veprimtaria e tij është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Sistemi për sigurimin e cilësisë përdor instrumenta të ndryshëm që ndjekin një politikë të qartë për sigurimin e cilësisë e që përfshijnë dy aspekte kryesore: monitorimin e procesit të mësimdhënies/mësimnxënies dhe analizën e programeve studimore (kurrikulave) së bashku me përmbajtjen e programeve të lëndëve (syllabuset). Akreditimi dhe riakreditimi institucional i UET, është kryer bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. UET në vlerësimin e parë të jashtëm është akredituar për një kohëzgjatje prej 5 vite akademike. UET i është nënshtuar gjithashtu akreditimit të programeve të studimit, kontrollit të ligjshmërisë të

²² "Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë" (Ref. Nr. 37.2)

²³ "Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022" (Ref. Nr. 37.4)

²⁴ Evidenca Nr. 2

	ushtruar nga MASR në vitin 2014, vizitave monitoruese të MASR mbi kapacitetet akademike dhe infrastrukturore dhe rezultatet kanë qënë pozitive.			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Bazuar në Manualin dhe Strategjinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ngrihen grupe pune për probleme të veçanta, format e kontrollit, realizimin e anketave të performancës dhe të gjurmimit, etj. Duke u mbështetur tek raporti i RVB, diskutimeve në institucion si dhe dokumentin “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë”, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një politikë të qartë për sigurimin e cilësisë, duke krijuar kështu një kulturë të cilësisë në rang institucional, që përfshin parimet mbi të cilat ndërtohet siguri i brendshëm i cilësisë duke definuar qartë objektivat, standardet dhe strukturat përgjegjëse për këtë qëllim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngrë njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe sqarimet që u dhanë në institucion, rezulton se janë ngritur njësi për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të parë.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Mekanizmat dhe proceset e formalizuara iu vendosën në dispozicion GVJ, së bashku me sqarimet përkatëse për çdo proces në veçanti. Nga të gjitha këto GVJ konstatoi se ekziston një proces i vazhdueshëm i mbikëqyrjes së programit studimor.
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Sipas dokumentit F.VII “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë” instrumente kryesore për vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit përdoren: 1) sondazhet online të studentëve, që realizohen në Moodle dhe pastaj integrohen në sistemin për menaxhim të cilësisë; 2) diskutimet me studentët në fokusgrupet, të cilat përbëhen kryesisht nga student me mesatare mbi 7, nga të gjitha vitet e studimit. Analiza dhe përpunimi i rezultateve nga instrumentat e vlerësimit finalizohet në një raport, i cili u dërgohet drejtuesve dhe shefave të departamentit. Diskutohet mbi to dhe merren masa për përmirësime, ku si masë e parë zakonisht është që përgjegjësi i departamentit thërret pedagogun, informon atë mbi shqetësimin e ngritur dhe

	këshillohet për më tej.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Sipas “Manualit të Brendshëm për Sigurimin të Cilësisë” monitorimi i proceseve akademike kryhet në mënyrë periodike. Rezultatet e tyre raportohen pranë strukturave drejtuese, rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Nga rezultatet e monitorimit rekomandohen ndryshime dhe veprime, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë KSBC.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Referuar RVB, raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Institucioni ka hartuar dhe zbaton vazhdimisht një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, duke vlerësuar didaktikat, kurrikulën, përmbajtjen e moduleve. Institucioni kryen shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit. Rezultatet e vlerësimeve të brendshme të çdo programi përfshihen në raportet e vetëvlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimeve.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Për kryerjen e vlerësimit të procesit akademik, UET monitoron provimet, syllabuset, literaturën e përdorur, etj. Studentët përfshihen në këtë process nëpërmjet përfaqësimit të studentëve në KSBC, zhvillimin e pyetësorëve online, fokus grupet, dhe pjesëmarrjes në mbledhjet e hapura të departamenteve, etj.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të	Metodat kryesore që përdoren për vlerësimin e hapjes, zhvillimit dhe ecurisë së programit të studimit, deri në diplomimin e studentëve, daljen e tyre në tregun e punës apo studimet e mëtejshme janë: <ul style="list-style-type: none"> • Testet e standardizuara • Kontroll/observim në auditor; • Vlerësim me pikë; • Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module,

<p>standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>praktikë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët • Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës • Vlerësim i vlerësimeve të provimeve nga persona neutral, për të kontrolluar objektivitetin dhe paanshmërinë në vlerësimin e studentëve nga ana e pedagogëve të lëndëve. <p>(Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor “Informatikë Ekonomike”, Pika 5.)</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re se për vlerësimin përdoren instrumenta të tërthorta, si sondazhe, fokus grupe e intervista me studentët aktuale, ata të diplomuar, me personelin akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit. Sondazhet janë gjithpërfshirëse. Gjithashtu, nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit mundësohet analizimi i shpejtë i rezultateve të studentëve në studimet e tyre në UET, kalueshmëria për lëndë dhe pedagog, etj.</p> <p>Realizohen edhe observime gjatë orëve të mësimin, kryesisht për pedagogë të rinj, me qëllim dhënien e rekomandimeve për përmirësim të procesit të mësimdhënies.</p> <p>Janë përgatitur materiale dhe janë organizuar trajnime për informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe të studentëve për sigurimin e cilësisë dhe rolin e tyre në këtë proces.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="630 1176 782 1265">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="782 1176 997 1265">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="997 1176 1220 1265">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1220 1176 1437 1265">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së NJSBC²⁵ në institucion është ngritur KSBC, përbërja e të cilit me anëtarë të brendshëm e të jashtëm rrit gjasat për një sigurim më të mirë të cilësisë dhe përmirësimin e programit të studimit. Anëtarët e KSBC miratohen nga Senati i Universitetit dhe përfaqësojnë çdo fakultet, personelin ndihmës akademik, ose administrativ, Këshillin e Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues të ekspertëve të jashtëm. Gjithashtu, UET është përfshirë si partner në dy projekte europiane që kanë në fokus</p>

²⁵Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf, evidenca Nr. 8

	sigurimin e cilësisë së brendshme nga institucionet e arsimit të lartë (projekti TEMPUS “ENCHASE” ²⁶ dhe Erasmus+ QAINAL. ²⁷)			
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<p>Përgjegjësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë i takojnë strukturave përgjegjëse të cilat janë:²⁸</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it; • Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin ekuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit. • Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <p>Përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit.</p>			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Siç u theksua në kriterin e mësipërm, në KSBC ka përfaqësues nga njësi bazë kryesore përgjegjëse për programin e studimit, si dhe anëtarë të personelit ndihmës akademik e administrative, si dhe të studentëve.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Politikat e institucionit në lidhje me sigurimin e cilësisë garantojnë respektimin e etikës, integritetit akademik dhe paanshmërisë.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Bazuar gjithashtu në evidencën e Kriterit 2 në këtë nënseksion, në KSBC ka të paktën një ekspert të jashtëm. Nga bisedat GVJ me drejtuesit, rezulton se përfshirja e një eksperti të jashtëm garanton një vlerësim sa më objektiv të situatës së përgjithshme.			
Shkalla e përmbushjes së	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

²⁶ Evidenca nr. 37.5 “Fisha e projektit Enchase”

²⁷ Evidenca Nr. 37.6 “Fisha e projektit QAINAL” (Ref. Nr. 37.6)

²⁸ Evidenca Nr. 8, Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf, pika F.VII.5.

standardit				X
------------	--	--	--	---

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Strategjia, politika dhe të gjitha mekanizmat dhe procedurat në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë publike për studentët dhe të tjerët. Parimi i sigurimit të brendshëm të cilësisë është garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerëpër performancën e UET-it, njësive të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj. (Evidenca 37.2). ²⁹			
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni publikon në mënyrë periodike raportet nga vlerësimet e ndryshme të programeve studimore, duke respektuar etikën dhe privatësinë e personelit akademik konform legjislacionit për të dhënat personale.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vlerësimit merren parasysh në hartimin e një planiveprimi e masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara (Evidenca 37.3). ³⁰			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni, nëpërmjet Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë monitoron zbatimin e masave të marra dhe analizon impaktin e tyre, duke u munduar që të sigurojë efektivitetin e procesit të përgjithshëm të sigurimit të cilësisë.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Për arritjen e qëllimit të mësipërm, institucioni organizon edhe veprimtari periodike për të informuar studentët dhe personelin akademik në lidhje me ndryshimet që janë bërë si rrjedhojë e kërkesave dhe rekomandimeve të tyre, si dhe në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të dhëna nga monitoruesit e jashtëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------

²⁹ Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.pdf, F.VII.2.3.

³⁰ Plani Veprimtari KSBK 2018-2019.pdf

				X
--	--	--	--	---



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor "Informatikë Ekonomike", me profile: "Menaxhim Biznesi", "Financë dhe Bankë" "Universiteti Europian i Tiranës"

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Shërbimi ndaj studentit nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Zyra e Karrierës kryen funksione të lidhura me ofrimin e mundësive që studentët, gjatë kohës së studimeve, të mund të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes për tu integruar lehtësisht në tregun e punës, por bën edhe ndjekjen e tyre pas studimeve nëpërmjet UET Alumni.
2. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë.NJSBC, misioni i së cilës është t'i ofrojnë studentëve një edukim cilësor nëpërmjet procesit cilësor të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe partnershipit me tregun e punës.
3. Projektet e suksesshme ndërkombëtare, sidomos ato ku UET është edhe lider.
4. Sistemi i brendshëm elektronik i dokumentave midis punonjësve, sistemi elektronik LMS që ka krijuar një shkëmbim shumë të shpejtë dhe transparent të informacionit midis studentëve dhe pedagogëve, sistemi elektronik UMIS që ka siguruar shkëmbimin e shpejtë dhe transparent të informacionit midis sekretarisë dhe pedagogëve.

Pika të dobta:

1. Literatura e mangët në gjuhën shqipe, veçanërisht në lëndët e lidhura me informatikën.Disa prej literaturave të rekomanduara për studentët janë të vjetra, dhe në një fushë si informatika, kjo mund të konsiderohet një dobësi kurrikulare.
2. Fushat e kërkimit shkencor të stafit akademik të njësisë bazëështë më shumë e orientuar ndaj profilit ekonomik, e më pak ndaj atij informatik.
3. Nuk ka një plan apo politikë të shkruar për mënyrën se si bëhet pasurimi i bibliotekës me tituj.
4. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, janë publikuar në faqen e internetit vetëm në shqip.

Rekomandime:

1. Pasurimi i literaturës bazë të lëndëve me material shqip, qofshin këta libra të kohëve të fundit, apo leksione të parashkruara me përmbajtje të përditësuar në varësi të zhvillimeve të fushës.
2. Të përcaktohen qartë mënyra dhe frekuenca e pasurimit të bibliotekës me tituj.
3. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, tëpublikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.
4. Të orjentohej fusha e kërkimit shkencor të stafit akademik të njësisë bazë drejt tematikave ndërdisiplinare të kërkimit shkencor që lidhin aplikimin e Teknologjisë së Informacionit me disiplinat e menaxhimit dhe marketingut.

Results of the Evaluation of the Study Programme of the first cycle Bachelor in “Economic Informatics” with profiles “Business Management” and “Banking and Finance”, “European University of Tirana”

Strength and affirmations:

1. Student services through the Career Counseling and Student Care Office. The Career Office performs several functions closely linked to providing students with the opportunity, during their studies, to build their recognition network to easily integrate into the job market, but also to pursue their studies through UET Alumni.
2. Internal Quality Assurance. IBQA, has the mission is to provide students with quality education through teaching processes and scientific research of good quality, as well as partnerships with labour market.
3. Successful international projects, especially the ones in which EUT is a leader.
4. Internal Information System, which is widely used among the staff; the electronic system LSM has enabled a very quick and transparent information exchange between students and the academic staff, as well as the electronic system UMIS, which has enabled the exchange between the secretary and academic staff.

Weaknesses

1. Scarce literature in Albanian, especially in informatics modules. Some literature recommended to students is old, and in the fast forward-moving environment of the field of informatics this could be considered a curricula weakness.
2. The fields of scientific research of the academic staff of the department is mostly oriented in the economy profile, and barely so towards informatics.
3. There is no plan or written policy on how and at which frequency the number of the volumes in the university library is updated.
4. The information regarding study programmes, academic staff, activities and events, are only published online in Albanian.

Recommendations:

1. Enrich the basic literature of modules with materials in Albanian, either translated books recently published, or written lectures with updated content depending on the developments in the field.
2. Establish clearly the way and frequency of updating the university library.
3. The information related to study programmes, academic staff, different activities and events, should be published in at least one foreign language.
4. To orient the research area of the academic staff of the Department of Management and Marketing towards interdisciplinary research topics that relate the application of Information Technology to the management and marketing disciplines.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përmbushen plotësisht	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X